



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht”

ofruar nga

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Dr. Mimoza Kore

Prof.asoc. Valbona Loshi (Softa)

Tetor/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht”, Universiteti
“Aleksandër Moisiu”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Letërsisë dhe i Gjuhës shqipe
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 685 dt. 25.08 2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Nr. 7238/1 prot, datë 31.08.2018.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr.289 datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli gjashtë (6)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Departamenti i Letërsisë 2020-2021 7 (PAE)/0 (PAK) 2021-2022 7 (PAE)/0 (PAK) 2022-2023 7 (PAE)/0 (PAK) Departamenti i gjuhës shqipe 8 (PAE)/0 (PAK) 2021-2022 8 (PAE)/0 (PAK) 2022-2023 8 (PAE)/0 (PAK)
18	Numri i studentëve:	2022-2023/29 studentë 2021-2022 / 17 studentë

		2020-2021/ 27 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) i themeluar në vitin 2005, është një institucion i rëndësishëm i arsimit të lartë në Shqipëri dhe ka një rol të veçantë në formimin e specialistëve dhe kërkuesve në fusha si edukimi, biznesi, teknologjitë e informacionit etj. Fakulteti i Edukimit është një prej fakulteteve më të mëdha të këtij universiteti. Në Ligjin 80/2015, njësitë bazë të Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe (DL dhe DGJSH) janë përfshirë në procesin e akreditimit të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë-Letërsi-Anglisht”, në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.


Që në krye duhet të theksojmë se ky program studimi është riorganizuar përsëri me UMAS nr. 358, datë 12.07.2023, në Bachelor “Gjuhë-Letërsi”. Në vitin akademik 2023-2024 studentët u regjistruan për programin e ri dhe si pasojë, programi që po shqyrtojmë konsiderohet i mbyllur.

Arsyeja e këtij riorganizimi të ri ishte vështirësia që hasën studentët në tregun e punës ku më të pranueshmit si mësues për gjuhë dhe letërsi shqipe ishin ata që kishin mbaruar “Gjuhë Letërsi” në universitetet e tjera dhe jo studentët e këtij programi që kishin edhe anglishten. Konvertimi në programin e ri e gjeti stafin akademik të përgatitur, infrastrukturën gjithashtu dhe përshtatja e programit u bë si simotrat në universitetet e tjera.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ), i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në përputhje me dispozitat ligjore të MAS dhe ASCAL, i përbërë nga dy anëtarë: Prof. Dr. Mimoza Kore dhe Prof. Asoc. Valbona Loshi, zhvilloi vizitën në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD), prej dt 16-17 tetor 2023, grupi i ekspertëve është asistuar nga koordinatori teknik e ASCAL, Alma Arapi.

Takimi filloi me Dekananen e Fakultetit të Edukimit dhe përgjegjëset e departamenteve të Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë, të cilët ofrojnë programin e studimit Bachelor në “Gjuhë-Letërsi-Anglisht”. Takimet vijuan sipas agjendës së hartuar nga ASCAL, me grupin e realizimit të RVB, stafin akademik dhe studentët, si dhe me stafin administrativ. Vizita u krye fizikisht në të gjitha ambientet, si në sekretarinë mësimore, në bibliotekë dhe auditore. Shqetësimi i përgjithshëm ishte numri i vogël e gjithmonë në rrudhje i prurjeve të reja, çka vihej re në përgjithësi në programet e studimit në UAMD, por në mënyrë më të ndjeshme për këtë program studimi. Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), në punën për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19 / 122 Prot, datë 02.10.2024. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës njofton në ASCAL ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

SHKURTIME

DVV	-Dosja e Vetëvlerësimit
FE	-Fakulteti i Edukimit
GVJ	-Grupi i vlerësimit të jashtëm
GVB	-Grupi i vlerësimit të brendshëm
GJLA	-Gjuhë letërsi Anglisht
NJSBC	-Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PA	-Personel Akademik
PS	-Programi i studimit
PSZHPS	-Plani Strategjik i Zhvillimit të programit të studimit
RVB	- Raporti i vlerësimit të brendshëm
RVJ	-Raporti i vlerësimit të jashtëm



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht”

I. OFRIMI PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret	Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur, GVJ evidenton se institucioni i Arsimit të Lartë Publik, Universiteti “Aleksandër Moisiu” referuar në këtë Raport Vlerësimi me shkurtimin “UAMD”, është themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20.12.2005 dhe është riorganizuar në pesë njësi kryesore, një ndër të cilat është Fakulteti i Edukimit, i cili ofron programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht”. Ky program studimi është licensuar me VKM Nr. 685, datë 25.08.2010 (Evidencë 1- Procedura ASCAL – Pika 1. Vendim Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës). GVJ konstaton se programi i studimit është riorganizuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në vend, me ndryshime deri në masën 20%, për herë ta parë në vitin 2018, me Vendim Senati Nr.59, i cili u miratua nga MASR më 31.08.2018 (Evidencë 2/3- procedura ASCAL- Vendim Senati Per riorganizimin e programit Bachelor ne " Gjuhë Letërsi - Anglisht", UAMD; Shkresë Per miratimin e riorganizimit te programeve te Fakultetit te Edukimit (UAMD)). Së fundmi, programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht” është riorganizuar për herë të dytë, me Vendim të Senatit Akademik nr.31/ 2022 me ndryshime deri në masën 20%, i cili ofrohet nga Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe është miratuar nga MAS me shkresë Nr.2085/1 – më datë 27.06.2022. (Evidencë 10- procedura ASCAL- vendim për riorganizimin e programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht” nën masën 20%). GVJ mësoi nga vizita në institucion se ky program studimi ka pësuar një riorganizim tjetër për vitin akademik 2023-2024, nga i cili ka kaluar në emërtimin Gjuhë -Letërsi dhe nuk është objekt i këtij vlerësimi nga ekspertët. Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka kryer dy procese të akreditimit periodik institucional (viti 2017 dhe 2022). Nga procesi i fundit është akredituar pozitivisht për katër (4) vite (Evidenca 5-

	<p>procedura ASCAL- Vendim Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës). GVJ konstaton se "UAMD", i cili ofron këtë program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, të parashikuara në Statutin e universitetit "Aleksandër Moisiu", (Neni 3, 4, 7 - Misioni, Qëllimet dhe Zhvillimi i Veprimtarisë së institucionit), si edhe në planin e zhvillimit strategjik të tij (Evidenca nr.2- Statuti UAMD; Evidenca-3-Plani Strategjik UAMD 2020-2025).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>GVJ evidenton se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi-Anglisht", i cili për këtë proces vlerësimi, ka qenë ofruar nga Departamenti i Letërsisë dhe ai i Gjuhës Shqipe pranë Fakultetit të Edukimit, është hartuar në përputhje me zhvillimin e veprimtarisë së institucionit të parashikuar në Statut (Neni7) (Evidenca nr.2 - Statuti UAMD).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>GVJ, referuar dokumentacionit të paraqitur në Dosjen e Vetë Vlerësimit, gjen se programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përshtatje me Rregulloren "UAMD" dhe Planin e zhvillimit strategjik të tij (Evidencë 4.- Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025 ; Evidencë 5. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Në mbështetje të evidencave të depozituara lidhur me kapacitetet dhe burimet akademike specifike të institucionit konstatohet nga GVJ se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi-Anglisht", i cili për këtë proces vlerësimi, është ofruar nga dy departamente: Departamenti i Letërsisë dhe ai i Gjuhës Shqipe pranë Fakultetit të Edukimit. GVJ evidenton se në vitin akademik 2022-2023, Departamenti i Gjuhës shqipe ka angazhuar në këtë program studimi 8 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 2 me titullin shkencor Profesor i asociuar; 5 PAE me gradën Doktor i Shkencave dhe 1 Docent; dhe 2 (PAK) nga të cilët (1) me gradën shkencore Doktor dhe (1) Msc.(Evidencë 108 –Tabela 2).</p> <p>Përsa i përket Departamentit të Letërsisë, ai është i përbërë nga 7 personel akademik efektiv (PAE) viti akademik 2022-2023, nga të cilët 2 me titullin shkencor Profesor i asociuar dhe 5 PAE me gradën "Doktor i Shkencave" (Evidencë 107–Tabela 6.1). Në këtë program studimi janë angazhuar gjithashtu (4) personel akademik nga departamenti i Gjuhëve të Huaja për lëndët plotësuese (Evidencë 108 –Tabela 9). Numri i personelit akademik me këto kualifikime shkencore përmbush detyrimin primar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në vend, lidhur me kapacitetet akademike në formimin e</p>




	departamentit dhe angazhimin në mësimdhënie në PS në Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht”.			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht” ofrohet me 180 kredite, sipas sistemit (ECTS), realizohet me kohë të plotë në tre (3) vite akademike dhe i përket nivelit (6) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe ka kryer propozimin për regjistrimin në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me numër unik identifikimi 63BA0188S për PS Bachelor në Gjuhë Letërsi Anglisht (Evidencë 10-Dokumentacin shtesë- Kodifikimi i programeve te studimit UAMD 1). Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Letërsisë dhe të Gjuhës Shqipe pranë Fakultetit të Edukimit, i cili ofron këtë program studimi. Programi i studimit GVJ konstaton se kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit përmban veprimtaritë formuese të kategorive (A-E) sipas VKM 41, 2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të” , ku lëndët përmbajnë kreditet respektive, <i>por GVJ nuk evidenton dokumentacion mbështetës në DVV për kodin përkatës të tyre.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se Universiteti “Aleksandër Moisiu”, i cili ofron programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht”, ruan interesat dhe vlerat akademike e kulturore kombëtare, të parashikuara në dokumenta zyrtarë themeltarë të institucionit si Statuti, Rregullorja e instucionit dhe Plani i zhvillimit strategjik të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda	GVJ, në referencë me materialin e depozituar pranë ASCAL gjen se “UAMD” ka hartuar një sërë rregulloresh, në nivel institucioni dhe të njësisë kryesore, të cilat drejtojnë dhe sigurojnë mbarëvajtjen e programeve të studimit, ku janë të parashikuara ndarja e detyrave mes njësisë përgjegjëse dhe realizimi i analizës së vazhdueshme të punës së tyre. (Evidencë 5 Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_)




<p>institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Durrës. Evidencë 19.. Rregullore e Fakultetit të Edukimit; Evidence 25, Rregullore Departamenti, BA, MP, MSH; Evidence 25.1 Rregullore Letersia).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UAMD në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe ka hartuar e miratuar strategjinë institucionale të ndërkombëtarizimit (Evidencë 7 Strategjia-e-nderkombetarizimit-e-miratuar-2022-2024_ me-vendim-senati).</p> <p>GVJ konstaton se Fakulteti i Edukimit në kuadër të ndërkombëtarizimit, implementon projektin për programin e dyfishtë të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë në Shkenca Edukimi” me partner Universitetin Pedagogjik të Krakovës, Poloni. Në dokumentacionin shtesë të paraqitur nga institucioni, evidentohet se UAMD ka nënshkruar (84) marrëveshje bashkëpunimi mobilteti Erasmus+, të cilat janë zbatuar për mobilitetin e personelit akademik të prej njërive bazë.</p> <p>(Dok.shtesë-Mobilitetet Staf Student pika 8 dhe 17).</p> <p><i>GVJ nuk e konstaton të saktë referencën në RVB për evidencat 122 dhe 124, të cilat nuk pasqyrohen në DVV. Lidhur me parteneritetin dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit që ky institucion ka ndërtuar, GVJ konstaton referuar tabelës 5 se janë raportuar gjithsej (40) marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe jopublike, si edhe janë nënshkruar 84 marrëveshje ndër-institucionale të huaja (Evidencë 107/108 - Tabela 5; Evidencë 7- Strategjia-e-nderkombetarizimit-e-miratuar-2022-2024_ me-vendim-senati; Evidencë 110- Mobilitetet Staf Student pika 8 dhe 17).</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ shprehet lidhur me këtë kriter se nënshkrimi marrëveshjeve me institucione arsimore brenda dhe jashtë vendit kryhet nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projektet, <i>ku cilësohet marrëveshja e bashkëpunimit me DAR me numër reference 63, të cilën GVJ nuk e evidenton në dosjen e vetë vlerësimit.</i> Gjithashtu në RVB cilësohet se këto marrëveshje bashkëpunimi nuk kontribuojnë për praktikën profesionale, pasi programi i studimit bachelor në Gjuhë Letërsi – Anglisht nuk e përfshin atë në planin mësimor të tij. GVJ konfirmon këtë informacion.</p> <p>(Evidencë 1-dokumentacioni shtesë. Plani mësimor Gjuhë-Letërsi- Anglisht) .</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njëria përgjegjëse për</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD kryen në nivel institucioni analizën vjetore institucionale (Evidencë 22 Raporti i vlerësimit analitik UAMD), ku trajtohet çështja e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe</p>

programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	ndërkombëtarizimit. Po ashtu dhe njësitë bazë, departamenti i gjuhës shqipe dhe ai i letërsisë realizojnë analiza të punës së tyre vjetore. GVJ evidenton se realizohen raporte me të dhëna sasiore për veprimtarinë e departamenteve lidhur me këtë pike. (Dokumentacioni shtesë- pika 8 dhe 17- Mobilitetet Staf Student; Evidencë 3 - Projektet dhe mobilitetet; Dok.shtesë - Evidencë 5. 1 - Analiza vjetore, DGJSH 2021-2022; Dok.shtesë - Evidencë 5. Departamenti i Letërsisë, analizë vjetore 2020-2021).			
Konkluzione	GVJ gjen të referuar në tabelat përmbledhëse të dokumentacionit të depozituar në DVV se janë nënshkruar (40) marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme; UAMD ka nënshkruar 84 marrëveshje bashkëpunimi mobiliteti Erasmus+, të cilat kanë shërbyer për mobilitetin e personelit akademik të departamentit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Institucioni ka hartuar raporte mbi ecurinë e zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke evidentuar mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në	Ky program studimi është organizuar në lëndë e module të cilat janë pasqyruar në planin mësimor Dokument nr.21 të shoqëruara me kreditet përkatëse të caktuara sipas Sistemit European të Transferimit e të Grumbullimit të Crediteve (ECTS) si dhe me sqarimet përkatëse për tipologjinë e lëndës, semestrin dhe vitin akademik ku zhvillohet. Gjithashtu është bërë i mundur dhe krahasimi me sistemin amerikan të krediteve (USCr) çka u mundëson studentëve dhe lëvizshmëri e njohje edhe të këtyre

fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	krediteve.
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Ky program studimi synon përgatitjen e specilaistëve dhe mësuesve për gjuhë dhe letësi shqipe si dhe anglisht. Ky program studimi lejon ndjekjen e Masterit të Mësuesisë në ciklin e dytë të studimeve duke integruar studentët në tregun e punës, si në shkollat e vendit tonë, në shkolla e kolegje ndërkombëtare, institucione publike etj.</p> <p>Ky program studimi zhvillon kompetenca te studentet për zotërimin e njohurive të thelluara në gjuhën dhe letërsinë shqipe si dhe në atë angleze.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit “Gjuhë - letërsi – anglisht” është hartuar duke pasur parasysh legjislacionin në fuqi dhe konkretisht VKM nr. 41.dt.24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit” duke bërë dhe klasifikimin përkatës të disiplinave:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Kategoria A përmban (29 kredite) në masën 16 % b. Kategoria B përfshin lëndët Karakterizuese, (95 kredite) 53% c. Kategoria C përmban lëndët Ndërdisciplinore e integruese(24 kredite) në masën 13%. d. Kategoria D me Lëndët Plotësuese(24 kredite) në masën 14% e. Kategoria E, Lëndët përmyllëse (3 kredite) në masën 3 %.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmyllëse.</p>	NA




<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p><u>Ky program studimi ka zbatuar Ligjin e arsimit të lartë për hartimin e programeve, pranimin e studentëve dhe gjithë elementëve që kërkon ligji dhe udhëzimet përkatëse. Këto janë pasqyruar nga evidencat 49-75.</u></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Ky program studimi gati në 80% është i njëjtë me ato në universitete të tjera të vendit, në të njëjtën fushë studimi. Megjithëse emërtohet “Gjuhë-letërsi-anglisht”, anglishtja bëhet si gjuhë e huaj, tek lëndët plotësuese (kategoria D) vetëm me ndryshimin se ndryshe nga degët simotra shtrihet edhe në vitin III, çka na duket e pamjaftueshme për natyrën e kësaj diplome.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në dokumentin nr 25 jepen të gjitha kodifikimet e programeve të fakulteteve të tjera, por jo të FE dhe programit që po shqyrtojmë. Në RVB theksohet se UAMD ka krijuar një kodifikim të brendshëm që jepet me dokumentin nr 72, por ai është një dokument jo për kodifikim. Si përfundim nuk ka kodifikim të lëndëve të programit të studimit. GVJ konstaton se kodifikimi i programit të studimit është parqitur në dokumentacionin shtesë me numër 63BA0188S për PS Bachelor në “Gjuhë - Letërsi - Anglisht” 10, (Kodifikimi i programeve të studimit UAMD).</p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky program studimi nuk është i përbashkët midis institucioneve të tjera, por midis departamenteve të gjuhës shqipe, të letërsisë dhe të gjuhëve të huaja brenda njësisë kryesore FE.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Është një program i ngjashëm me simotrat në universitet e tjera. Mendojmë se megjithëse diploma përmban dhe emërtimin ‘anglisht’ kjo lëndë bëhet në nivelin e mësimit të gjuhës së huaj si në çdo program studimi, pra nuk ka peshën e duhur në formën e studentit për të qenë në emërtim. Nuk ka kodifikim të lëndëve, por ndarja e lëndëve është bërë</i></p>




	<i>sipas VKM nr. 41.dt.24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit" duke bërë dhe klasifikimin përkatës të disiplinave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore dhe ato bazë (departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë) të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e këtij program studimi plotësojnë kriteret dhe detyrimet e përcaktuara në Ligj. Këto janë të shprehura në dokumentet nr. 48, 70, 72 dhe jo në dokumentet që ka paraqitur RVB (nuk përkojnë numrat)</p> <p>GVJ konstaton se Fakulteti i Edukimit ka në përbërjen e tij gjashtë departamente dhe një qendër:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Letërsisë • Departamenti i Gjuhës Shqipe • Departamenti i Psikologjisë • Departamenti i Sociologjisë • Departamenti i Pedagogjisë • Departamenti i Gjuhëve të Huaja • Qendra e Edukimit në Vazhdim <p>Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë-Letërsi-Anglisht" është pjesë e dy departamenteve Departamentit të Letërsisë dhe Departamentit të Gjuhës Shqipe.</p> <p>Në departamentin e letërsisë për vitin 2020-2021 janë të përfshirë 7 pedagogë PAE dhe 0 pedagog PAK; për vitin 2021-2022 janë të përfshirë 7 pedagogë PAE; për vitin 2022-2023 janë të përfshirë 7 pedagogë PAE dhe 0 PAK (Ref.nr 107-Tabela 2).</p>




Tituj/grada	2020-2021		2021-2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	2	-	2	-	2	-
Dr/PhD	5	0	5	-	5	0
Msc	-	-	-	-	-	-
Në total	7	0	7	0	7	0

Departamenti i Gjuhës Shqipe për tri vitet akademike ka në përbërjen e tij:

Tituj/grada	2020-2021		2021-2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	2	-	2	-	2	-
Dr/PhD	6	0	6	-	6	0
Msc	-	-	-	-	-	-
Në total	8	0	8	0	8	0

Evidenca nr 108 , tabela2

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Ky program studimi nuk ka në dispozicion një laborantë si staf ndihmës akademik. Këtë detyrë e kryen një anëtar i sekretarisë mësimore.

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë

Njësitet bazë të realizimit të këtij programi kanë përcaktuar në shkresën nr. 4502, dt.23.02.2021 personin përgjegjës për departamentin e gjuhës

përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	shqipe në rolin e koordinatorit dhe është caktuar G. Krasniqi. <i>GVJ evidenton se kodifikimi i programit të studimit është depozituar tek dokumentat shtesë, informacion i cili paraqitet i ndryshëm më referencën në RVB (Ref. Evidencë 17.Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD, Shkresa e Rektorit; Ref. Dok shtesë-Pika 28-Evidenca 10).</i>			
Konkluzione	GVJ gjykon se departamenti i gjuhës shqipe dhe ai i letërsisë kanë burimet e duhura logjistike, akademike dhe organizative për ofrimin e këtij programi studimi. Programi i studimit është i kodifikuar dhe koordinohet nga personel akademik efektiv i departamentit të gjuhës shqipe përgjegjës për të. Ky program studimi mbulohet 100% nga personel akademik efektiv.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia kryesore dhe njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi kanë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve shprehur në dokumentet1. Statuti,2. Plani i zhvillimit strategjik, 3. Rregullore e UAMD. (dokumentet e referuara ne RVB nuk perputhen).
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të	Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve (<u>Evidence 39 Ngarkesa mesimore</u> , orët në auditor/jashtë auditorit).

lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.				
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në dokumente ekziston dosja e studentit, por jo kriteret e pranimit në këtë program studimi. Ato janë dhënë vetëm për nivelin master. Nuk ka dokumentacion për transferimin dhe ekuivalentimin e studentëve.			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Ky program studimi përmban informacionin e nevojshëm për lëndët e silabuset, seminarët, kreditet për secilën, orët e realizimit në përputhje me formatet e miratuara. Të gjitha lëndët formuese kanë nga 4 kredite. Ka lëndë me zgjedhje që kanë 8 kredite, çka na duket jo e drejtë, sepse ato luajnë një rol më të vogël në formimin e studentit.			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Ky program studimi u konvertua këtë vit në Bachelor në “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, kështu që po zbatohet vetëm për studentët që janë në proces.			
Konkluzione	<i>Ky program studimi përmban informacionin e nevojshëm sipas formateve të miratuara për planin mësimor dhe programin e studimit. Nuk ka informacion për kriteret e pranimit të studentëve e po kështu për vijimësinë dhe po mbyllet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve mundësojnë thellim të njohurive dhe vijimesi për programin e studimit të mëvonshëm., Master professional, Mësuesi Praktika nuk ka në këtë stad studimi, ajo zhvillohet në Ciklin e dytë të studimeve) studimit të mëvonshëm.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Lëndët dhe modulet janë shpërndarë mirë në semestra e në përputhje me shkallën e vështirësisë që vjen e rritet nga viti në vit. (dok. 7). Shpërndarja në kredite mendojmë që mund të bëhej më mirë. Konkretisht ju janë lënë më shumë kredite lëndëve; Teknologji të mësimdhënies (5 ECTS) apo Interpretim letrar (5 ECTS) kur lëndë më formuese për tipologjinë e këtij programi janë vlerësuar me më pak kredite.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Mendojmë se ky program studimi nuk i aftëson studentët në lëndët e anglishtes. Kjo gjuhë merret vetem si njohuri për gjuhën e huaj sin ë çdo program tjetër studimi, prandaj raporti që zë në krahsim me ato të gjuhës dhe të letërsisë është i vogël</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim</p>	<p>Ndarja është bërë sipas veprimtarive formuese, por nuk mundësojnë transferim studentësh në degët simotra të universiteteve të tjera për shkak të lëndëve të anglishtes dhe emerimit të kësaj diplome. Ky është dhe një nga shkaqet që ky program studimi u transformua në të ngjashmet dhe po mbyllet.</p>




të studimeve.			
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Sudentët e ktij program studimi kishin vështirësi për të hyrë në tregun e punës, sepse si mësues të gjuhës e të letërsisë preferohen ata që kanë mbaruar bachelorin në këtë drejtim. As si mësues të anglishtes nuk integroheshin, sepse njohuritë në këtë drejtim janë të pamjaftueshme.		
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi siguron përfitim e njohurive në gjuhë dhe letërsi shqipe, por jo sa duhet në anglisht. Kjo e dyta zhvillohet si lëndëe gjuhës së huaj dhe jo si për student që mbarojnë degën e anglishtes. Prandaj mendojmë se në këtë të dytën studentët nuk sigurojnë kompetencat e duhura.		
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ky program studimi iu jep mundësi studentëve të vazhdojnë Master profesional (mësuesi).		
Konkluzione	<i>Programi i studimit është strukturuar sipas kërkesave të duhura e të aprovuara, është ndarë në semestra e kredite, por në disa raste iu është dhënë kredite më shumë disa lëndëve jo aq të rëndësishme për forimin e studentëve. Raporti i lëndëve të drejtimit gjuhë dhe letërsi shqipe me atë anglisht është jo i drejte. Lëndët e anglishtes janë në nivelin e mësimit të një gjuhe të huaj dhe jo formuese. Studentët me këtë program studimi, siç na u pohua nga stafi akademik gjejnë vështirësi në tregun e punës dhe në mobilitet.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Në dokumentin nr.83 (evidencë, studimi tregu) i cili është për master Profesional (mësuesi) është evidentuar pse tregu i punës ka nevoja për studentët që mbarojnë Bachelor Gjuhë dhe letrësi dhe me tej ata në master professional. Por nuk ka evidencë ku tregohet studimi i tregut për këtë program, sepse nuk mund të punësohen me 3-vjeçar.</p> <p>Po kështu në Evidencën 30 tregohet krahas degëve të tjera të UAMD edhe sa student që kanë mbaruar MP janë punësuar.</p> <p>Në dokumentin 49 ekziston pyetsori i studentëve për vlerësimin e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentin nr.49 ekziston pyetsori i studentëve për vlerësimin e programit të studimit.</p> <p>Në dok. Nr 3 jepen të dhëna për studentët e diplomuar për të gjithë universitein e midis tyre dhe të këtij programi, por nuk ka të dhëna për konsultime me ish-studentë.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e</p>	<p>Vitin e kaluar ky program studimi u ndryshua vetëm në Gjuhë dhe leërsi shqipe dhe nuk ka ndonjë të dhënë për përmirësimin e tij në vitet e kaluara.</p>



mjekësisë) dhe institucione publike e private.				
Konkluzione	<i>Është bërë një studim për tregun e punës për studentët që mbarojnë master Profesional si vijim i programit Gjuhë -letërsi - anglisht. Nuk ka të dhëna për konsultime me alumni, po kështu për përmirësime të programit gjatë viteve të zbatimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi- Anglisht, GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët dhe orët e studimit individual. Ky program studimi nuk përmban punë laboratorike dhe praktikë profesionale (Evidencë 1. Plani mesimor Gjuhe-Letersi- Anglisht) Ndërsa esetë dhe projektet janë parashikuar në syllabus dhe sistemin e vlerësimit institucional si forma për vlerësimin e vazhdueshëm përgjatë vitit akademik. Orët e hapura parashikohen në planin e punës dhe rregulloret e departamenteve përkatëse, konkretisht atë të gjuhës shqipe dhe letërsisë. (Evidencë 25 Evidence 25, Rregullore Departamenti, BA, MP, MSH; Evidencë 16. Aktivitetet shkencore të miratuara nga Rektorati Dep. gjuhës dhe i letërsisë).
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,	GVJ konstaton se personeli akademik është në përpjekje të vazhdueshme për t'iu përgjigjur nevojave të studentëve përsa i përket mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kjo gjetje evidentohet nga takimi me studentët dhe me personelin akademik, të cilët kishin koherencë në diskutimet e tyre. Gjithashtu, reflektohet edhe në

<p>mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>formën e kontrollit të njohurive, ku përgatitja dhe prezantimi i detyrës së kursit/projekteve/ punimeve individuale të studentëve është i detyrueshëm për zhvillimin e aftësive krijuese dhe analitike (Ref. vizita në institucion; Syllabuset e lëndëve; Evidencë 31. Rregullore GJ-LA). Në RVB lidhur me këtë kriter specifikohet realizimi i detyrave të kursit dhe i projekteve nga studentët për të forcuar mendimin kritik dhe aftësitë kërkimore duke iu referuar evidencës 67, konkretisht formularit të vlerësimit të programit të studimit nga studentët. <i>GVJ gjen në DVV se kjo referencë nuk përkon me përmbajtjen e cituar</i> (Evidencë 67 Rregullore e mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar udhëzues të posaçëm, sa i takon mbështetjes së personelit akademik për përmirësimin e aftësive didaktike (Evidence 45-Udhëzues për metodat e mësimdhënies). Gjithashtu UAMD, në strukturën e tij organizative, ka ngritur Qendrën e Edukimit në Vazhdim, pranë Fakulteti të Edukimit, e cila promovon rritjen e kompetencave didaktike në përputhje me rezultatet e të nxënit, duke ofruar trajnime për personelin akademik dhe njëkohësisht programe studimi për studentët. Njëkohësisht personeli akademik i departamenteve të gjuhës shqipe dhe letërsisë është angazhuar në disa projekte ndërkombëtare të shkëmbimit në kuadër të programeve Erasmus+ të financuara nga Bashkimi Evropian me qëllime trajnimi dhe mësimdhënëse në disa universitete të huaja në shtete si Hungari, Lituani, Austri, Gjermani.</p> <p>(Evidencë 8. Mobilitetet e stafit akademik).</p> <p>GVJ vlerëson faktin se institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe aftësive kërkimore duke financuar projekte të paraqitur nga departamenti i gjuhës shqipe dhe letërsisë, si dhe në realizimin e leksioneve të hapura, konferencave shkencore.</p> <p>(Evidencë – Dokumentacioni shtesë - 17. Projektet e stafit akademik; Evidencë 35 -Aktivitetet shkencore dep. i gjuhës.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht” janë angazhuar personel akademik nga tre departamente: Departamenti i Letërsisë, Gjuhës Shqipe dhe Gjuhës angleze pranë Fakultetit të Edukimit. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë. GVJ evidenton se Departamenti i Gjuhës shqipe ka angazhuar në mësimdhënien në program studimi (8) personel akademik efektiv (PAE) nga viti 2020-2023, nga të cilët 2 me titullin shkencor Profesor i asociuar; 5 PAE me gradën Doktor i Shkencave dhe 1 Docent (Evidencë 108 –Tabela 2).</p>




mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

Tituj/grada	2020-2021		2021-2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	2	-	2	-	2	-
DR./PhD	5	0	5	-	5	0
Dr/doc.	1	0	1	0	1	0
Msc	-	-	-	-	-	-
Në total	8	0	8	0	8	0

Ndërsa Departamentit i Letërsisë ka angazhuar (7) personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 2 me titullin shkencor Profesor i asociuar dhe 5 PAE me gradën Doktor i Shkencave.

Ref.nr 107-Tabela 2.

Tituj/grada	2020-2021		2021-2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	2	-	2	-	2	-
Dr/PhD	5	0	5	-	5	0
Msc	-	-	-	-	-	-
Në total	7	0	7	0	7	0

Në referencë më të dhënat sa më lart, GVJ konstaton se ngarkesa mësimore për këtë departament mbulohet 100% nga PAE, e cila shkon përtej kuotimit të përcaktuar me ligj prej 70%.

Megjithatë, në referencë me tabelën 4, në ngarkesën totale të PA për vitin akademik 2022-2023, deklarohet një (1) (PAK) i angazhuar në mësimdhënie në PS Bachelor “GJLA” (Evidencë 108 –Tabela 4). *GVJ vëren një mospërputhje të kësaj të dhëne të paraqitur nga institucioni në këtë pikë.*

Në këtë program studimi janë angazhuar gjithashtu (4) personel akademik nga departamenti i Gjuhëve të Huaja për lëndët plotësuese (Dok. Shtesë- Evidencë 1. Plani mësimor Gjuhe-Letersi-Englisht).

GVJ konstaton se numri i personelit akademik me këto kualifikime shkencore, të deklaruar në dokumentacion, përmbush detyrimin

	<p>primar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në vend, lidhur me kapacitetet akademike lidhur me gradat shkencore që duhet të ketë personeli akademik për t'u angazhuar në mësimdhënie në PS Bachelor GJLA.</p> <p><i>GVJ vëren se në RVB, për këtë kriter përmendet rregullorja për rekrutimin e stafit akademik, por GVJ nuk e evidenton atë në DVV (Referencë 140-142 - Aneksi II).</i></p> <p>GVJ evidenton se PA në mënyrë të vazhdueshme ndjek trajnime, aktivitete shkencore dhe është i angazhuar në projekte ndërkombëtare në kuadër të rritjes së kapacitetit të tyre; konkretisht në vitin akademik 2023-2024, PA ka qenë i angazhuar në 8 projekte gjithsej, në nivel departamentit dhe të huaja, nga të cilat 3 projekte janë financuar nga UAMD. (Dok. Shtesë Evidencë 17-Projektet e stafit akademik). Cilësia e PA dhe përfshirja e tyre në aktivitete shkencore trajtohet në analizën vjetore të departamentit të gjuhës shqipe.</p> <p>(Evidencë Shtesë 2. Analiza vjetore, DGJSH 2021-2022 (3); Evidencë shtesë 5. Departamenti i Letersise, analize vjetore 2020-2021).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se DGjSh dhe DL kryejnë takime informale me studentët për të marrë mendimet e tyre me qëllim përmirësimin e formave të mësimdhënies. Të dhënat zyrtare të studentëve që dalin nga anketimet ose pyetësorët të miratuar nga strukturat përgjegjëse të tilla si NJSBC, Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe kurrikulave reflektohen në raportet vjetore të departamentit me qëllim evidentimin e problematikave dhe dhënien e rekomandimeve për zgjidhjen e tyre, në funksion të përmirësimit të programit të studimit në nivel departamenti.</p> <p>(Ref. vizita në institucion; Dokumentacion shtesë 5.1 Analiza vjetore, DGJSH 2021-2022; Evidencë shtesë 5-Departamenti i Letersise, analize vjetore 2020-2021.</p> <p>Studentët kryesisht reflektonin përfshirje në pyetësorët institucionalë, ku dhe u shprehën se gjenin zgjidhje më të mira si rezultat i opinioneve të tyre.</p> <p>(Evidencë - 74. Mbarevajtja e procesit mësimor). <i>GVJ rekomandon përfshirjen e studentëve në strukturën NJSBC e cila siguron standartet e cilësisë në nivel fakulteti.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e</p>	<p>GVJ evidenton se UAMD, mbështetur në Statut, ka ngritur struktura të tilla si: “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”, (NJSBC) e cila garanton standartet e cilësisë në nivel fakulteti;</p> <p>(Dok. Shtesë 14. Urdhër për ngritjen e NJSBC; Evidencë 11 Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).</p>




<p>vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Qendra e Edukimit në Vazhdim, e cila realizon trajnime për personelin akademik lidhur me zbatimin e metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p>Në RVB, lidhur me këtë kriter, është specifikuar se studentët kryejnë vlerësimin për personelin akademik, si dhe japin sugjerime. <i>GVJ gjen se referenca e cituar lidhur me këtë çështje lidhet me vlerësimin institucional nga ana e studentëve dhe jo specifikisht me vlerësimin e secilit pedagog për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</i></p> <p>(Evidencë 69. Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin).</p> <p>GVJ konstaton në dokumentacionin shtesë se është realizuar raporti sasior i vlerësimit të pedagogëve, i shprehur në përqindje për një pjesë të personelit akademik (PAE /PAK) për të dy departamentet, atë të Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë. GVJ rekomandon që pyetësorët të aplikohen për të gjithë personelin akademik efektiv dhe me kontratë, si edhe është parashikuar në urdhrin e Rektoratit bashkëlidhur në raport, si edhe sugjeron departamentet të realizojnë analizë më të thelluar të rezultateve lidhur me vlerësimin e pedagogëve dhe programit të studimit.</p> <p>(Dok.shtesë 17. Raporti vjetor i pyetesoreve, 2021-2022. 5.1 Analiza vjetore, DGJSH 2021-2022).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve nëpërmjet kuadrit të kualifikimeve shkencorë të personelit akademik, ku vërehet pajisja e tyre me grada shkencore dhe pjesërisht me tituj shkencorë. Po ashtu PA në mënyrë të vazhdueshme ndjek trajnime dhe aktivitete shkencore në kuadër të rritjes së kapacitetit të tyre. Fakulteti i Edukimit ka ngritur në strukturën e tij Qendrën për Edukimin në Vazhdim, dhe në nivel institucional ka ngritur Drejtorinë e marrëdhënieve me jashtë dhe projektet. GVJ evidenton se PA në mënyrë të vazhdueshme ndjek trajnime, aktivitete shkencore dhe është i angazhuar në projekte ndërkombëtare në kuadër të rritjes së kapacitetit të tyre. Studentët janë të përfshirë për të shprehur opinionet e tyre në pyetësorët institucionalë dhe vlerësimin e personelit akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB-së, GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi- Anglisht”, përcaktohen në kuadrin rregullator të brendshëm të institucionit të tilla si: Rregullorja e Universitetit “Aleksandër Moisiu” (neni 68); Rregullorja e Fakultetit të Edukimit (Neni 66), por edhe në rregullore të posaçme si Rregullorja e Programit të studimit Bachelor “Gjuhë Letërsi- Anglisht”, të cilat parashikojnë se procedurat dhe kriteret e vlerësimit, përcaktohen në syllabuset e lëndëve dhe u bëhen të ditura studentëve në orën e parë të zhvillimit të kursit. Këto rregullore kanë unifikuar sistemin e vlerësimit të studentit, ku forma e vetme e kontrollit të dijes është provimi me shkrim, që realizohet në formatin e provimit të ndërmjetëm, në javën e shtatë ose të tetë të strukturës mësimore dhe atij final në përfundim të lëndës.</p> <p>(Evidencë 5 Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës; Evidencë 31. Rregullore GJ-LA).</p> <p>GVJ eidenton se vetëm 10 % e vlerësimit përfundimtar të studentëve i kushtohet detyrave të kursit ose projekteve sipas programit të kursit të miratuar. 90% e vlerësimit realizohet nëpërmjet provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit mbështetës, si dhe vizitës në institucion, konkretisht takimi me studentët dhe personelin akademik, GVJ konstaton se studentët njihen me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. Në Nenin 62 të Rregullores “UAMD” dhe në syllabuset e lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi dhe Anglisht”, shprehen qartë format e vlerësimit të dijes dhe bërja publike e tyre që në orën e parë të prezantimit.</p> <p>(Evidencë 5. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës; Evidencë 2.1-Dokumentacion mbështetës - Syllabuset e lëndëve).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ eidenton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, se në tabelën 15 për format e kontrollit të njohurive janë përcaktuar pjesët në përqindje për çdo formë vlerësimi, ku vërehet se provimi përfundimtar zë 50% të totalit të vlerësimit përfundimtar; testimi gjatë vitit (provimi i ndërmjetëm) zë 40 % dhe zhvillohet në javën e shtatë ose të tetë të strukturës mësimore; detyrat e kursit, projektet, esetë zënë 10 % të vlerësimit përfundimtar. GVJ konstaton se kjo ndarje mes kategorive të vlerësimit është reflektuar edhe në syllabuset e</p>




	<p>lëndëve, të cilët përcaktojnë edhe kategorinë për frekuentim të detyrueshëm të lëndës, e cila nuk duhet të jetë më pak se 75% dhe nuk zë peshë në vlerësimin përfundimtar të lëndës.</p> <p>(Referencë 107-108 - Tabelat përmbledhëse – Tabela 15).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Statuti “UAMD” (Neni 89, pika c/ç) parashikon përfshirjen e studentëve në proceset e vendimmarrjes të institucionit, në nivel njësie bazë dhe kryesore, si edhe të shprehin vlerësimin e tyre për personelin akademik dhe cilësinë e programeve të studimit.</p> <p>(Evidenca-2- Statuti UAMD, 2018).</p> <p>GVJ ka gjetur në DVV raportin e të dhënave për vlerësimin institucional nga studentët dhe PA, si edhe raportin me të dhëna sasiore për vlerësimin e personelit akademik.</p> <p>(Evidencë 69 -_Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin; Evidencë 17. Raporti vjetor i pyetesoreve, 2021-2022; Evidencë 17.1 Raporti vjetor i pyetesoreve, Departamenti i Gjuhës shqipe, 2020-2021). GVJ mësoi nga vizita në institucion se vlerësimi për programin e studimit kryhet nga vetë departamenti. <i>GVJ konstaton se në raportet e departamentit kryhet analiza e procesit mësimor dhe shkencor të tij, por nuk pasqyron të dhëna për vlerësimin e programit të studimit nga studentët referuar pyetësorit përkatës.</i></p> <p>(Evidencë 40. Pyetësor i vlerësimit të programit).</p> <p>GVJ konstaton se studentët përfshihen në këtë proces dhe në raportet vjetore të departamentit realizohet analiza e rezultateve që dalin nga pyetësorët e studentëve lidhur me vlerësimin e PA, me qëllim evidentimin e problematikave dhe dhënien e rekomandimeve. (Dokumentacion Shtese 2. Analiza vjetore, DGJSH 2021-2022; Evidencë 5. Departamenti i Letersise, analize vjetore 2020-2021).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar infrastrukturën në përshtatje të përdorimit të disa metodave fleksible pedagogjike në funksion të programit të studimit, të tilla si: shfrytëzimi i bibliotekës on-line https://ulibrary.rash.al/; sigurimi i cilësisë së mësimdhënies e parashtruar në Politikat e Cilësisë të Fakultetit të Edukimit. <i>GVJ evidenton domosdoshmërinë e kryerjes së Studimit të Tregut të Punës, për orientimin e tyre në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht”, pasi në referencë evidentohet STP për programin Master Profesional (Evidencë 72 Evidencë Studim tregu MPGJL).</i></p>




ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.									
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se kuadri rregullator i brendshëm i institucionit, i cili përfshin Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu"(neni 68), Rregulloren e Fakultetit të Edukimit (Neni 66), por edhe në rregullore të posaçme si Rregullorja e Programit të studimit Bachelor "Gjuhë Letërsi- Anglisht, parashikon se procedurat dhe kriteret e vlerësimit përcaktohen në syllabuset e lëndëve dhe u bëhen të ditura studentëve në orën e parë të zhvillimit të kursit. GVJ evidenton domosdoshmërinë e kryerjes së studimit të tregut të punës për orientimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi-Anglisht". GVJ konstaton se studentët përfshihen në procesin e vlerësimit të personelit akademik dhe programit të studimit dhe në raportet vjetore të departamentit realizohet analiza e rezultateve që dalin nga pyetësorët e studentëve lidhur me këto vlerësime. GVJ sugjeron që në tilla raporte të bëhet evidentimi i problematikave me synim dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tyre.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ evidenton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, se në tabelën 15 për format e kontrollit të njohurive janë përcaktuar pjesët në përqindje për çdo formë vlerësimi, ku vërehet se provimi përfundimtar zë 50% të totalit të vlerësimit përfundimtar; testimi gjatë vitit (provimi i ndërmjetëm) zë 40 % dhe zhvillohet në javën e shtatë ose të tetë të strukturës mësimore; detyrat e kursit, projektet, esetë zënë 10 % të vlerësimit përfundimtar. GVJ konstaton se kjo ndarje mes kategorive të vlerësimit është reflektuar edhe në syllabuset e lëndëve, të cilët përcaktojnë edhe kategorinë për frekuentim të detyrueshëm të lëndës, e cila nuk duhet të jetë më pak se 75% dhe nuk zë peshë në vlerësimin përfundimtar të lëndës. (Referencë 107-108 në sistem- Tabelat përmbledhëse – Tabela 15). Këto forma të vlerësimit janë parashikuar në rregulloret përkatëse. Në Nenin 62 të Rregullores "UAMD" dhe në syllabuset e lëndëve




	<p>të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë-Letërsi -Anglisht”, shprehen qartë format e vlerësimit të dijës dhe bërja publike e tyre që në orën e parë të prezantimit.</p> <p>(Evidencë 5 Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar informacionit në RVB, dokumentacionit mbështetës, si edhe takimit me personelin akademik, GVJ konstaton se me qëllim shmangien e abuzivitetit dhe rritjen e transparencës, institucioni vë në përdorim sistemin elektronik Cleanscore në testime, duke përdorur “barcode” për të ruajtur konfidencialitetin e të testuarit dhe vlerësimit të tij në kushte transparente. Nga vizita në institucion GVJ mësoi se ky modalitet përdoret me kërkesë nga ana e pedagogut për t’u aplikuar.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar në lëndët e këtij programi studimi kryhet në bazë të shumës së pikëve të grumbulluara përgjatë vitit dhe është rezultat i tre (3) treguesve: 1-vlerësimit i vazhduar, (100 pikë) (zhvillimi i projekteve, eseve, detyrave të kursit); 2-vlerësimi i ndërmjetëm gjatë semestrit/ vitit akademik për elementët e përcaktuar në programin e lëndës të llojit: një provim i ndërmjetëm, (400 pikë) 3-vlerësimi me anë të provimit final, (500 pikë). Vlerësimi përfundimtar është i mirëpërcaktuar në fomë tabelare sipas konvertimit të përqindjes, pikëve të grumbulluara, notës dhe të shprehurit me fjalë. Ky lloj vlerësimi është në përputhje me bazën ligjore për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor (VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL”).</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Referuar informacionit në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht” shoqërohet me këshilla mbi procesin e të nxënës për rezultatet në detyrat e kursit, projektet dhe provimet e ndërmjetme, si edhe me komente kryesisht përgjatë vlerësimit përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ evidenton nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion se departamenti i Gjuhës shqipe dhe i Letërsisë në mbështetje të rregullores UAMD dhe rregulloreve të departamentit, sigurojnë shmangien dhe mos lejimin e plagjiaturës, si dhe mos kopjimin në provime dhe detyra, nëpërmjet identifikimit të studentit pjesëmarrës në provim, ndaljes së përdorimit të mjeteve komunikative osë bazës materiale përveç asaj të lejuar në sallën e provimit, si edhe nëpërmjet parashikimit si shkelje disiplinore dhe</p>




	<p>të dënueshme të kopjimit ose plagjiaturës. (Evidenca-5- Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës. Neni 70/ 116). <i>GVJ evidenton nga vizita në institucion se ky parashikim respektohet në praktikë, por nuk mëson të dhëna konkrete përsa i përket sigurimit të sistemit kundër plagjiaturës.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura në DVV, evidentohet nga GVJ se rezultatet e studentëve ngarkohen në sistemin Pitagora ku realizohet përlllogaritja e notës sipas pikëve totale të studentit nga vlerësimi i vazhduar, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar. Në rastin e provimit përfundimtar është titullari i lëndës i cili përcakton datën dhe orën se ku bëhet shpallja e rezultateve, e cila nuk duhet të jetë më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit. Në përfundim të procesit, nota pasqyrohet në procesverbalin e vlerësimit dhe regjistrin e rezultateve. (Evidenca-5- Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës. Neni 69, pika 7).</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në referencë me materialin e paraqitur në DVV, GVJ gjen se neni 71 i rregullores "UAMD" parashikon ankimimin e provimeve, ku si procedurë studenti i drejton ankesën me shkrim përgjegjësit të njësisë bazë, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga publikimi i rezultatit. Pasi drejtuesi i njësisë kryesore njihet me ankesën, ai ngre një komision ad-hoc për rishikimin e saj. Rishikimi i tezës nga grupi ad-hoc realizohet në prani të studentit dhe komisionit dhe në rast se rishikimi sjell ndryshim të vlerësimit përfundimtar të notës, atëherë kjo e fundit pasqyrohet në procesverbalin e kursit. (Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018). GVJ nuk konstatoi raste të kontestimit të notës nga takimi me studentët në institucion. Studentët konfirmuan se kishin mundësi të konsultonin pikët e provimit final me pedagogun e lëndës dhe se i mernin paraprakisht pikët e provimit të ndërmjetëm dhe të detyrës së kursit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjen se "UAMD" ka ndërtuar një sistem transparent të testimit dhe vlerësimit të studentit, i cili garanton një vlerësim të drejtë, të mbështetur në meritë dhe në përputhje me legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në vend. Studentët e programit të studimit janë të njohur me procedurat e testimit dhe vlerësimit, si edhe për mundësinë për ankimin e notës, pavarësisht se nuk e kanë aplikuar atë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Pas shqyrtimit të kurrikulës mësimore të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë-Letërsi-Anglisht”. GVJ konstaton se kuadri i përgjithshëm formues i tij është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL-të”, për kategorinë “Bachelor”:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Kategoria A përmban (29 kredite) në masën 16 % b. Kategoria B përfshin lëndët Karakterizuese, (95 kredite) 53% c. Kategoria C përmban lëndët Ndërdisiplinore e integruese(24 kredite) në masën 13%. d. Kategoria D me Lëndët Plotësuese(24 kredite) në masën 14% e. Kategoria E ,Lëndët përmblylëse (3 kredite) në masën 3 %. <p><i>Pavarësisht këtij konstatimi, GVJ vëren se në kategorinë e lëndëve karakterizuese (B) e cila përmban 15 lëndë gjithsej, anglishtja është e përfaqësuar me vetëm një lëndë “Civilizim dhe letërsi anglo-amerikane” me (6) kredite nga (95) kredite që përmban e gjithë kategoria e lëndëve karakterizuesë për këtë program studimi. Ndërkohë që lëndët e gjuhës angleze janë konsideruar si lëndë plotësuese në kategorinë D. Kjo shkon ndesh me emërtimin Gjuhë Letërsi-Anglisht dhe ndërtimin e këtij programi studimi.</i></p> <p>(Dokumentacioni shtesë-Pika 25-26- Evidencë 1. Plani mesimor Gjuhe-Letersi- Anglisht).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në kategorinë (C) të programit të studimit janë përfshirë lëndët me zgjedhje të cilat aftësojnë studentët në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale të tilla si: aplikim kompjuteri në gjuhësi, analizë diskursi, sociologjia e letërsisë, psikolinguistikë, shkrim krijues.</p> <p>(Dokumentacioni shtesë-Pika 25-26- Evidencë 1. Plani mësimor Gjuhë-Letërsi- Anglisht).</p> <p><i>GVJ rekomandon përfshirjen e këtyre lëndëve në kategorinë D të lëndëve plotësuese në përputhje me VKM 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL-të”. GVJ konstaton se në kategorinë (D) është përfshirë gjuha angleze</i></p>




	I,II,III duke e konsideruar atë sipas kësaj VKM-je si lëndë plotësuese, e cila si rregull, duhet t'i përkiste kategorisë A (lëndë bazë) dhe B (lëndë karakterizuese), në përputhje me emërtimin e programit të studimit "Gjuhë - Letërsi -Anglisht".
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Referuar syllabuseve të lëndëve në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi-Anglisht", GVJ evidenton se kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Nga takimi me personelin akademik u evidentua se para provimit përfundimtar kryhet një përsëritje të koncepteve themelore me efekt orientimin e studentëve. Provimi final kontrollon 60% të njohurive të marra në 7 javët e fundit të semestrit dhe 40% të njohurive të marra në 7 javët e para.</p> <p><i>Lidhur me këtë kriter, në RVB citohet rregullorja Bachelor në evidencën 13. GVJ nuk e gjen të depozituar atë sipas kësaj reference (Evidencë 13 Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore).</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se mësimdhënia realizohet pjesërisht mbi bazën e kompetencave, të cilat janë parashikuar në syllabuset e lëndëve në formën e realizimit të detyrave të kursit, projekteve, eseve apo prezantimit të projekteve semestrale, por që zënë vetëm 10 % të peshës totale të vlerësimit, si dhe nuk përmban orë laboratorike. <i>GVJ konstaton që ky program studimi nuk e ka përfshirë praktikën profesionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM 41/2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL-të").</i></p> <p>Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve, ku një pjesë e tij reflekton eksperiencë në pjesëmarrje aktive në mësimdhënie dhe trajnime në kuadër të projekteve të huaja të financuar nga Bashkimi Evropian. GVJ konstaton rastin e një mobiliteti nga PS Bachelor në "Gjuhë Letërsi -Anglisht" për një semestër në universitetin Kodolayi, Hungari. (Dok. Shtesë Evidencë 8. Mobilitetet e stafit akademik).</p> <p><i>GVJ vëren se dokumentacioni shoqëruar lidhur me mobilitetin e studentit i referohet programit të studimit administrim biznesi (Evidencë 55. Praktikë për mobilitet të studentëve). GVJ vlerëson faktin e shpalljes publike të thirrjeve për mobilitet të studentëve dhe personelit akademik të UAMD.</i></p> <p>(54 Evidencë Mobiliteti i studentëve).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi</p>	<p>GVJ konstaton se departamentet e Gjuhës dhe Letërsisë kanë organizuar disa aktivitete shkencore dhe leksione të hapura, ku ndër të tjera evidentohen:</p> <p>Scientific Session: "Comparative approach in the Balkan</p>




zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Literature” -Qasje krahasuese në letërsinë ballkanike ; “ Language – education - socialization”; “Language and its impact on socialization, and social interaction & the role of education in the practical use of language”- Gjuha – arsimi - shoqërimi Gjuha dhe ndikimi i saj mbi shoqërimin dhe e bashkëveprimin shoqëror & roli i arsimit në përdorimin praktik të gjuhës. (Evidencë 16.Aktivitetet shkencore të miratuara nga Rektorati DEP GJUHES LET 37 Evidenca 37Aktivitetet e organizuara nga Departamenti i Gjuhes shqipe).			
Konkluzione	GVJ konstaton se format e mësimdhënies në këtë program studimi ndërthuren me aftësitë e fituara nga mobiliteti i personelit akademik në projekte ndërkombëtare me qëllim trajnimi dh e mësimdhënie. GVJ vëren se në planin mësimor të programit të studimit “Gjuhë Letërsi-Anglisht”, në kategorinë e lëndëve karakterizuese (B), e cila përfshin 15 lëndë gjithsej, anglishtja është e përfaqësuar me vetëm një lëndë “Civilizim dhe letërsi anglo-amerikane” me 6 kredite nga 95 kredite që përmban e gjithë kategoria e lëndëve karakterisueze për këtë program studimi. Ndërkohë që lëndët e gjuhës angleze janë konsideruar si lëndë plotësuese në kategorinë (D).Ky program studimi nuk e ka të përfshirë lëndën e praktikës profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	GVJ konstaton se Rregullorja e diplomimit është përfshirë në rregulloren e programit të studimit Gjuhë -Letërsi –Anglisht. Kjo rregullore përcakton se pas përfundimit të këtij program studimi studenti mund të diplomohet me punim diplome ose me provim të përgjithshëm, për zhvillimin e të cilës, studenti diplomant drejton një kërkesë pranë Sekretarisë Mësimore të FE, së paku dy javë para të datës së shpallur për diplomim. <i>Kjo rregullore nuk e përkufizon prapun e notës mesatare për mbrojtjen me temë diplome .</i> (Evidencë 31. Rregullore GJ-LA).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli	GVJ evidenton se për realizimin e detyrimit përmbyllës të diplomimit studentët e programit Bachelor në “Gjuhë- Letërsi -

<p>akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Anglisht” asistohen nga disa struktura si: departamenti i gjuhës shqipe dhe ai i letërsisë; sekretaria mësimore; personeli akademik të cilët u vënë në dispozicion studentëve diplomantë udhëzime administrative dhe akademike në përmbushje të detyrimit final, atë të diplomimit. Studentët kanë mundësi që nëpërmjet dy formularëve, konkretisht 1.-Formulari i Kërkesës për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi. 2.- Kërkesë për Provim Formimi për diplomimin me provim të përgjithshëm e shprehur nëpërmjet kërkesës për t’u regjistruar në provimin/temën e diplomës” të plotësuar, sipas formatit të miratuar.. Ata mund të përzgjedhin udhëheqësin shkencor për punimin e diplomës. (Evidencë 43. Rregullore diplomimi + anekset+ ndryshimet , BA, MSH, MP).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Referuar Rregullores së Diplomimit GVJ evidenton se komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final përbëhet nga jo më pak se tre (3) anëtarë deri në (5) anëtarë, të cilët propozohen nga departamenti dhe miratohen në Dekanat. Gjithashtu studentëve u vihet në dispozicion fondi i pyetjeve për provimin e përgjithshëm, si edhe lista e temave të diplomave në fillim të semestrit të parë të vitit akademik. Studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij në jo më pak se 20 minuta, ndërsa udhëheqësi i tij nuk mund të bëjë pjesë në komisionin e posaçëm të mbrojtjes. (Evidencë 31. Rregullore GJ-LA).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Evidentohet nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion se me fillimin e semestrit të dytë të vitit akademik, në bazë të mundësive për udhëheqje, në përputhje me natyrën e fushës së studimit dhe në përputhje me kërkesën e studentit për udhëheqësin shkencor përcaktohen rastet e mbrojtjes me tezë diplome nga departamenti. Neni 9 i Rregullores të diplomimit përcakton qartë detyrimet e udhëheqësit shkencor në mentorimin e punës së kandidatit për hartimin e tezës. Nëpërmjet grafikut të konsultave për ecurinë e temës, udhëheqësi orienton studentin në hartimin e temës , të cilën e miraton përpara mbrojtjes së saj. (Evidencë 43 Rregullore diplomimi + anekset+ ndryshimet , BA, MSH, MP).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit</p>	<p>Referuar informacionit në RVB si dhe nga takimi në institucion GVJ mësoi se personeli akademik pranë departamentit orienton dhe asiston studentët në realizimin e analizave kryesisht në mjediset UAMD.</p>





apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ evidenton se Neni 76 i Rregullores së Fakultetit të Edukimit përcakton se vlerësimi përfundimtar i tezës së provimit të përgjithshëm ose mbrojtjes së diplomës bëhet me notë dhe llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit. Vlerësimi në këtë rast kryhet nëpërmjet një liste kontrolli të treguesve për vlerësimin e diplomës. Ky vlerësim pasqyrohet në procesverbal dhe i bëhet e ditur studentit, jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit. Studenti që kalon me sukses tezën e diplomës/provimin e përgjithshëm përfundimtar pajiset me diplomën përkatëse. (Evidenca- 19. Rregullore e Fakultetit të Edukimit; Evidencë 43 Rregullore diplomimi + anekset+ ndryshimet , BA, MSH, MP)
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ dëshmon se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi Anglisht”. (Evidenca-2- Statuti UAMD, 2018.Neni, 76; Evidenca 29. Supplement, Bachelor Gjuhe-Letersi-Anglisht). Nga vizita në institucion, GVJ verifikoi se kryesekretarja regjistron në regjistrin e diplomave dhe të suplementeve të notave, diplomat e fituara dhe suplementet e protokolluara, përpara se të tërhiqen.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Përgjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ u njoh me tre forma të regjistrimit të të dhënave të studentëve: 1- regjistri themeltar, ku ruhen bazat e të dhënave të studentëve dhe çdo student pajiset me numër të vecantë matrikullimi;2.-regjistri i arritjeve akademike që përmban rezultatet e studentëve; 3. - regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave, të cilët sigurojnë ruajtjen e tyre në përputhje me ligjin në fuqi. (Evidenca-2- Statuti UAMD, 2018, Neni 92).
Konkluzione	<i>GVJ verifikon se UAMD, konkretisht Fakulteti i Edukimit dhe dy njësitë bazë të tij që ofrojnë PS Bachelor Gjuhë Letërsi –Anglisht ndjekin një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit përsa i përket procedurave akademike dhe administrative të diplomimit me provim të përgjithshëm ose me tezë diplome. Në përfundim të studimeve Bachelor, institucioni e pajis studentin me diplomën dhe Suplementin e saj. GVJ rekomandon vendosjen e pragut të notës mesatare për pranimin e kërkesës së studentit për diplomim me punim të tezës së diplomës, pasi nuk e gjen atë të publikuar në rregulloret përkatëse.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1								
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.								
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve							
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Ky program studimi realizohet nga staf akademik i brendshëm (PAE). Mënyra e rekrutimit të tyre është përcaktuar në dokumenti nr. 6 (Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës) dhe në dok.nr 33, nr. 34. (Rregullore e departamenteve Gjuhë dhe Letërsi). Personeli akademik i këtij program studimi e plotëson nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit. Kualifikimi shkencor i tyre fillon nga grada Doktor.							
	Tituj/grada		2020-2021		2021-2022		2022 – 2023	
			PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr		-	-	-	-	-	-
	Prof.As.Dr		1	-	2	-	2	-
	Dr/PhD		6	-	5	-	5	-
	Msc		-	-	-	-	-	-
Në total		7	0	7	0	7	0	

Për programin e studimit janë angazhuar nga departamenti i Gjuhës Shqipe si më poshtë:

Tituj/grada	2020-2021		2021-2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	2	-	2	-	2	-
DR./PhD	5	0	5	-	5	0
Dr/doc.	1	0	1	0	1	0
Msc	-	-	-	-	-	-
Në total	8	0	8	0	8	0

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akademik i këtij program studimi mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me legjislacionin. Sipas fushës së studimit dhe kualifikimit shkencor jepen dhe lëndët përkatëse dhe ndahet dhe ngarkesa në orë e pedagogëve. Ky program studimi mbulohet 100% nga personel akademik efektiv, që superon kufinj të 70% të parashikuara me ligj për një program studimi. Ka një mospërputhje të të dhënave në raportimin e tabelave për personelin akademik, ku evidentohet se raportohet një (1) PAK i angazhuar në mësimdhënie në PS Bachelor “GJLA” nga Departamenti i gjuhës shqipe për vitin akademik 2022-2023, por në tabelat referuese për departamentin rezultojnë (PAE).

(Evidencë 108 –Tabela 2; Evidencë 108 –Tabela 4).

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe

Në këtë program studimi janë aktivizuar staf akademik (PAE), të cilët kanë nënshkruar një kontratë me kohë të pacaktuar për kategorinë lektor dhe profesor dhe kontratë me afat të caktuar për kategorinë asistent lektor, sipas legjislacionit në fuqi. Në rastin e kontratave me afat të pacaktuar, ato rinovohen automatikisht çdo vit nga përgjegjësi i njësisë bazë, kurse ato me afat të pacaktuar nënshkruhen çdo fillim semestri në bazë të nevojave. Të gjitha detyrimet me sigurime shoqërore dhe shëndetësore plotësohen nga universiteti (A. Moisiu). Në evidencën me nr rendor 50 janë paraqitur kontratat e punës për çdo pedagog dhe të nënshkruara prej tyre.

mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Universiteti “A. Moisiu” në rregulloren e paraqitur në dokumentin nr. 6 ka paraqitur në nenin 103 të gjitha kriteret dhe procedurat që ndiqen në këtë universitet për rekrutimin e stafit të ri akademik. Pasi vijjnë aplikimet, me një afat kohor 10 ditor, vetëm me anë të shërbimit postar, ato protokollohen dhe i kalojnë me firmë Sektorit të Burimeve Njerëzore, i cili gjatë 5 ditëve në vijim, bën ndarjen e dosjeve sipas njësive bazë dhe ia dorëzon me procesverbal kyetarit të komisionit <i>ad hoc</i> . Drejtuesi i njësisë kryesore krijon komisionin <i>ad hoc</i> për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Komisioni e bën vlerësimin në dy faza- vlersimi i dosjes së kandidatit (70%) dhe - intervista (30%). Pas intervistave, komisioni <i>ad hoc</i> plotëson formularin dhe vendos pikët e aplikantëve, të cilat ia paraqet Dekanit dhe Sektorit të Burimeve Njerëzore. Këta me një shkresë përcjellëse ia paraqesin Rektorit fituesit dhe ky i fundit lidh kontratën e punës me pedagogët e rinj. Njoftimi bëhet në mënyrë elektronike dhe në faqen e universitetit. Nëse asnjë aplikant nuk plotëson kriteret e shpallura nga kjo njësi bazë, procesin e anulon Rektori. Gjithashtu na është paraqitur edhe një dokument (Evidencë nr 23, 2020-2021) mbi kriteret e përzgjedhjes së lektorëve të jashtëm. Nga shqyrtimi i personelit akademik prej nesh, vërejtëm se të gjithë e plotësonin kriterin për të dhënë mësim në këtë program studimi.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Ky program studimi nuk ka në dispozicion një personel ndihmës akademik (sekretare departamentesh) të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm. Laboratori ekziston vetem tek departamenti i gjuhëve të huaja, i cili është gjithashtu realizues i këtij programi.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje	Çdo vit akademik stafi i programit Bachelor në “ Gjuhë-Letërsi-Anglisht” përditëson të dhënat personale dhe punën shkencore në përputhje me legjislacionin në fuqi (dok. Nr.4 Statuti i Universitetit “A. Moisiu”, dok.nr.6 Rregullore e programit të studimit të Universitetit “A. Moisiu”, kreu XIV neni 100). Në RVB flitet dhe për rregullore të Zyrës së personelit akademik, por nuk e gjetëm në dokumente.




<p>me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni, pranë zyrës së burimeve njerëzore disponon të gjithë anëtarët e stafit akademik të brendshëm, të jashtëm dhe të atij ndihmës akademik të përditësuar për çdo semestër. Një material të tillë mban dhe përgjegjësi i çdo departamenti që mbulon këtë program studimi. Krahas të dhënave personale shënohet dhe kontributi shkencor i çdo anëtari të stafit të brendshëm.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, ka vendosur marrëdhënie me institucionet e arsimit në rrethin e Durrësit, duke qene se ky program studimi përgatit kryesisht mësues si dhe me institucione shkencore si ASA për udhëheqje diplomash të studentëve. Nuk gjetëm marrëveshje me institucioonet e tjera. Në Evidencën 8 jepet një material, miratuar nga Senati i këtij Universiteti ‘Strategjia e Ndërkombëtarizimit’ , por në lidhje me këtë program studimi nuk gjetëm marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Ky program studimi i nivelit Bachelor nuk e përmban praktikën profesionale.</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin</p>	<p>NA</p>




përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Institucioni ruan të dhënat personale të personelit. Ky program studimi nuk ka praktikë profesionale e cila kryhet në nivelet e mësipërme. Dokumentacioni shoqerues, megjithëse citohet, nuk gjendet ose nuk përkon numri rendor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Fakulteti i Edukimit është një godinë e re me një kapacitet prej 23 sallah të cilat marrin nga 50 deri 120 studentë. Po kështu ka një sipërfaqe prej 724 m ² për zyra. Të gjithë auditorët janë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimin, të pajisur me videoprojektor, ngrohje dhe dritë natyrale dhe me lartësi 3.0 m. Fakulteti ka ujë të bollshëm dhe plotëson kriteret. Këto u panë nga GVJ në institucion, sepse nuk gjejmë në dokumenta ndonjë të dhënë përveç përshkrimit në RVB. Gjithashtu në dokumentin 55 Raport vjetor për monitorimin e cilësisë, nuk gjetëm të dhëna për infrastrukturën.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që	Për kryerjen e një mësimi sa më cilësor, mjediset veçanërisht të këtij fakulteti janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme, me mjete elektronike. Çdo anëtar i stafit është i pajisur me monitor. Në dokumentin nr. 80 Rezultatet e anketimit të studentëve, këta të fundit rezultojnë të kënaqur me teknologjinë, mundësinë e aksesimit në të dhe të përdorimit gjatë mësimdhënies. Në dokumentin nr. 62 Strategjia e sektorit të teknologjisë dhe informacionit vihen detyra për të ardhmen për përmirësimin dhe


garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	ruajtjen nga rreziqet e ndërhyrjes në të dhënat dhe mbarëvajtjen e mësimin.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Të gjithë auditorët ku zhvillohet ky program studimi kanë mundësinë e përdorimit të mjeteve të reja teknologjike për të plotësuar nevojat e përshatshme për realizimin e moduleve dhe kërkesave të këtij programi, i cili nuk ka nevojë për laboratorë specifikë përveç atij të gjuhës angleze.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Ky program studimi nuk ka nevojë për laborator të teknologjisë së informacionit. Shfrytëzohet vetëm laboratorin i gjuhëve të huaja për mësimin (lexim e dëgjim) për lëndët e anglishtes.			
Konkluzione	<i>GVJ në gjetjet që bëri në institucion, verifikoi se infrastruktura, auditorët, zyrat janë me sipërfaqe të mjaftueshme, me cilësinë e duhur.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme).




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në çdo silabus që na u vu në dispozicion, kishte literaturë të detyruar bazë dhe atë fakultative. Në pyetjet që i drejtuam studentëve na u përgjigjën që marrin literaturë. Personeli akademik në shumë lëndë i ka pajisur studentët me tekste mësimore, të miratuara në department. Në RVB bëhet fjalë për një Memo të teksteve mësimore në department (citojmë sipas RVB 252), por ne nuk gjetëm midis dokumentave një të tillë. Leksione në formë të printuar studentët gjejnë edhe në bibliotekën e fakultetit. Po kështu, për këtë program studimi, duke qenë Gjuhë-letërsi-anglisht, litaratura është e gjendshme me lehtësi dhe biblioteka, të cilën ne si GVJ vizituam ishte e pasur.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Pedagogët janë të përditësuar me literaturën e re që lidhet me këtë program studimi, çka pasqyrohet në silabuset e disjplinave përkatëse, të cilat paskëtaj nëshkruhen nga përgjegjësi i departamentit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik një bibliotekë moderne që ofron të gjitha mundësitë për shfrytëzim. Ajo është krijuar në vitin 20007 dhe është e ndarë në tri godina. Biblioteka nr. 2 e Fakultetit të Edukimit shtrihet në godinën nr.1. Ajo përmban 12000 mijë tituj (dok.nr. 38) kurse në RVB thuhet 8000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj. Ka një kapacitet prej 238.8 m² dhe 120 vende. Nga vizita në të vërejtëm se punonjëset ishin të përkushtuara, e njihnin mirë bibliotekën dhe na sqaruan se biblioteka funksionon sipas Ligjit nr 8576, 03.02.2000, neni 30, "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë". Kjo bibliotekë ka marrëdhënie me simotrat jashtë prej nga merr edhe tituj të rinj në shkëmbimet që bëhen. Biblioteka ka marrëdhënie dhe përfiton nga bashkëpunimi me UNRICD në Zvicër. Literatura që përmban është nga të gjitha lëmitë shkecore, por ne u përqëndruam në ato të gjuhës shqipe, letërsisë dhe anglisht. Pamë që në bibliotekë nuk mungonin periodikët e këtyre fushave si "Studime filologjike", tekstet dhe litaratura e nevojshme për letërsinë.</p> <p>Në sallën e bibliotekës ka mundësi kërkimi i literaturës online, gjithashtu ka një sallë kompjuterash ku studentët mund të punojnë të vetëm apo në grup për realizimin e detyrave. (shih: dokum. Nr 38)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të</p>	<p>Biblioteka ishte e pajisur me fond fizik për shumë nga tekstet mësimore dhe për ato që mungonin ishin depozituar ciklet e leksioneve. Fondi vlerësojmë se ishte i mjaftueshëm për këtë program studimi dhe pasurohej periodikisht me tituj të rinj. Në dokumentin nr 76 " Informacion për bibliotekën online) jepej lista e peridikëve për çdo program studimi të cilat studentët mund t'i</p>

<p>huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>aksesojnë dhe online. Biblioteka ka internet gjithë kohës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Në dok.nr 5 "Plani strategjik i UAMD" theksohet që të gjithë studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën e Fakultetit. Biblioteka shfrytëzohet pa pagesë dhe online mund të shfrytëzohen të dhënat nga JSTOR, EPSCO, UNRISD. Çdo student e pedagog mund të hapë një kartelë pa pagesë dhe biblioteka disponon 2000 të tilla.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike, si ai COBISS që mundëson kërkimin shkencor nga ana e studentëve dhe pedagogëve. Këtë program studentët mund ta shfrytëzojnë edhe nëpërmjet telefonit. (Nuk gjendet dokumenti që referohet në RVB "Modul i trajnimit të programit COBISS)</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka universitare qëndron e hapur prej orës 8.00-16.00 brenda kohës kur studentët janë në proces mësimor. Online ajo mund të shfrytëzohet deri në orën 20.00.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online</p>	<p>Universiteti gjatë planifikimit të buxhetit vjetor, merr parasysh kërkesat e njësive bazë në të cilat janë depozituar kërkesat e secilit pedagog për literaturë. Nuk pamë ndonjë dokument ku të pasqyrohej raportimi për cilësitë dhe kërkesën për përditësim të bibliotekës.</p> <p>Nga shqyrtimi në vend i bibliotekës, punonjëset na informuan për fondin fizik, mundësitë online etj. Se sa të efektshme kanë qenë propozimet për pasurimin e fondit, nuk kemi informacion.</p>




nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>GVJ, duke parë nga afër bibliotekën e këtij fakulteti është e mendimit se kushtet fizike dhe fondi i gjetur në të i plotëson kriteret për një bibliotekë cilësore. Vërejmë se një pjesë e dokumentacionit të referuar në RVB nuk gjendej.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni, njësitë bazë përgjegjëse ndjekin gjithë ecurinë e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim e tij. Kjo arrihet me anë të strukturave përkatëse, si Sekretaria Mësimore, Zyra e karrierës dhe Alumnit dhe njësitë bazë. Në dokumentin nr. 75 “Model dosje studenti” jepet dokumentacioni i përcaktuar nga MASR për regjistrimin e studentit. Po kështu studenti pajiset me nr. matrikulimi dhe rezultatet mësimore disponohen nga sekretaria mesimore.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit	Në UAMD funksionon një sistem i brendshëm i menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit për stafin akademik, në letër dhe në formë elektronike. Ky sitem monitoron arritjet shkencore, titujt akademikë, ngarkesën e personelit të brendshëm dhe çdo të dhënë që nevojitet për të. Po kështu menaxhohen dhe të dhënat për stafin ndihmës akademik. Gjithë ky sistem përbëhet nga Njësia




<p>akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>kryesore, Njësitë bazë, Dega mësimore, Dega e financës dhe ajo e burimeve njëzore. Për sa i përket të dhënave që paraqiten në RVB si, regjistra elektronikë të ZSS etj, ne nuk i gjetëm në dokumentacion.</p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Këto janë të përcaktuara dhe në dokumentin nr.27 Rregullore e FE. Studentë e pedagogë janë të informuar me programin, oraret, kanë akses në linkun e paraqitjes së rezultateve të provimeve.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Kjo arrihet me anë të sistemit Pitagora. Përveç të dhënave të provimeve, nëpërmjet këtij sistemi studenti njihet me të drejtën ose jo për të hyrë në provim. Për të komunikuar me studentët pedagogët përdorin dhe Google classroom, Zoom si dhe nëpërmjet adresave të emailit.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Kjo përcaktohet edhe në dokumentin nr.27 Rregullore e FE</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit www.UAMD.edu.al</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në dok.nr. 35 jepet një raport i shpenzimeve financiare. Nuk është i detajuar dhe specifikisht për tri njësitë bazë që mbulojnë këtë program. Gjithashtu janë dhënë në total për të gjithë universitetin shpenzimet për pagat, studentët etj. për vitin 2018-2019 por jo për ciklin e plotë të studimit që kemi marrë në shqyrtim.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Dokumenti nr. 35 për shpenzimet financiare përmban financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online. Të gjitha këto janë dhënë në kuadrin e përgjithshëm të UAMD.
Kriteri 3. Institucioni	Institucioni kryen auditim nga grupi i eksperteve të auditit të




kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	brendshëm të institucionit. Të ardhurat financiare vijnë nga burime shtëtrore, nga studentët dhe të tretët. Auditimi kryhet rregullisht.			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në mbyllje të një cikli studimesh bëhet raportim mbi kostot financiare të tri viteve të fundit nga Dega e Auditit të brendshëm. Në Dokumentin nr. 35 për shpenzimet financiare, janë dhënë të gjitha realizimet si dhe shpenzimet e përcaktuara në rang institucioni (UAMD).			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Duke u mbështetur në raportet financiare, institucioni garanton vijueshmërinë duke pasur parasysh mënyrën e përmirësimit të situatës dhe risqet e mundshme.			
Konkluzione	<i>Politika e Financimit është dhënë në kuadër të gjithë Universitetit, por jo specifikisht për këtë program studimi, prandaj nuk krijohet dot një pamje të qartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ evidenton se informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese si edhe përmes fushatave promovuese (https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit).</p> <p>GVJ konstaton se studentët janë të përfaqësuar në organe të ndryshme të institucionit. Ata mbështeten me politika dhe procedura, të cilat u krijojnë atyre trajtim të njëjtë për të studiuar, për t'u informuar, për t'u vlerësuar, për infrastrukturën në mbështetje të programit të studimit, për mobilitete etj. përgjatë viteve të studimit deri në diplomimin e tyre.</p> <p>(Evidenca nr.2 – Statuti UAMD, kreu VI, neni 57, 62; Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, kreu III, neni 44; Evidenca nr.7 – Rregullore FE, Kreu V, neni 45).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV, evidentohet nga GVJ se politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Këto procedura dhe politika mbështeten në Ligjin e Arsimit të Lartë, në udhëzimet e MAS, por edhe në kuadrin rregullator të brendshëm të UAMD.</p> <p>(Evidenca nr.2- Stauti UAMD, Kreu VI; Evidenca nr.7 – Rregullore FE, nenet 45,58; Evidenca Rregullore e programit të studimit)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe</p>	<p>GVJ nuk gjen referencë në dosjen e paraqitur për verifikimin e kriterëve të pranimit të kandidatëve për studentë në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi-Anglisht”, si dhe nuk verifikon referencën e cituar në RVB për këtë kriter (Evidencë 68 Kriteret e pranimit te studenteve MP). GVJ konstaton se në Rregulloren e PS Bachelor në Gjuhë Letërsi – Anglisht KREU IV, pika a/c/d janë parashikuar kritere për pranimin e studentëve në Masterin Shkencor (Evidencë 31. Rregullore GJ-LA).</p>




<p>udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Përgjatë vizitës në institucion dhe inspektimit të faqes zyrtare të UAMD, (https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit) mund të verifikohen kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve. Gjithashtu, institucioni ka aktivizuar sistemin e menaxhimit të informacionit Pitagora, që siguron shpërndarjen e informacionit mbi përparimin gjatë studimeve, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, proces i cili aksesohet lehtësisht (https://uamd.edu.al/pitagora/).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe anëtarë të departmentit të gjuhës shqipe dhe letërsisë, GVJ mësoi se të interesuarit njihen me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit nëpërmjet aktiviteteve informuese me nxënës maturantë, përmes organizimit të ditëve të hapura që organizon UAMD, por edhe nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Njësia kryesore, Fakulteti i Edukimit duhet të mbajë në mbikqyrje veprimtarinë rregullatore të brendshme për njësitë bazë, të cilat hartojnë parashikimet për kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi - Anglisht. Konkretisht rregullorja e këtij programi studimi specifikon kriteret për regjistrim dhe pranim në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor. (Evidencë 31. Rregullore GJ-LA.pdf- Kreu IV, Neni 23, pika a/c/d).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Neni 23 i Rregullores së programit të studimit për përzgjedhjen e kandidatëve për studentë që vijnë nga shtete të tjera ka përcaktuar që ata duhet të përmbushin të njëjtat kritere si studentët nga Shqipëria. (Evidenca 31– Rregullore e programit të studimit). <i>GVJ nuk konstaton parashikimin e kritereve dhe kuotave me Vendim Senati për këtë kriter.</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për</p>	<p>GVJ konstaton se Statuti UAMD ka përfshirë në politikat mbështetëse të ndihmës financiare studentët nga shtresat në nevojë përmes bursave të studimit. (Evidenca nr.2 – Statuti UAMD, neni 99).</p>

zhvillimin ekonomik të vendit.				
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se informimi publik për maurantët dhe të interesuarit në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë – Letërsi- Anglisht" realizohet nëpërmjet udhëzimeve të nevojshme në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit përmes faqes zyrtare të institucionit, fushatave promovuese, aktiviteteve informuese, organizimit të ditëve të hapura, guidave. GVJ konstaton se rregullorja e këtij programi studimi specifikon kriteret për regjistrim dhe pranim të studentëve në ciklin e dytë të studimeve "Master Shkencor"; po ashtu, GVJ, megjithëse gjen në Statut parashikimin për mbështetje financiare të disa kategorive të studentëve, nuk evidenton ndonjë vendim zyrtar me numrin e kuotave dhe kriterëve të pranimit për studentët nga trojet, të etnive të ndryshme ose me status të shtresave në nevojë për këtë program studimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, GVJ gjen se informacioni i plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentit vihet në dispozicion përmes sekretarisë mësimore, pedagogut të lëndës dhe komunikimit nëpërmjet e-mailit.</p> <p>(Evidenca nr.7 – Rregullore FE, kreu VII; Faqja web:www.uamd.edu.al).</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	<p>Informacioni mbi programin e studimit, mundësinë dhe njohjen e krediteve në rast transferimi të studimeve, për regjistrim në program të dytë apo ripranim, si edhe në rastet e mobilitetit të studentëve përmes programit Erasmus + përcillet nga departamenti ose sekretaria mësimore.</p> <p>(Referencë-Vizita në institucion: takim me studentët, takim me drejtueset e departamenteve, takim me stafin akademik)</p>
Kriteri 3. Institucioni	Nga vizita në institucion u mësua se përveç ditëve të orientimit në

informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	takimet informuese me studentët, pedagogu përkatës prezanton studentët, që në orën e parë të zhvillimit të lëndës, me formën dhe procedurat e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit si pjesë e sylabusit të lëndës. Gjithashtu, studentët informohen mbi këto kriteret dhe procedura përmes takimeve në departament, faqes së ëeb-it të UAMD, si edhe nga sekretaria mësimore.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Departamenti i gjuhës shqipe dhe i letërsisë vënë në dispozicion të studentëve rregulloren për punimin e tezës së diplomës, e cila përmban gjithë udhëzimet e nevojshme mbi punimin e tezës së diplomës si edhe kriteret e vlerësimit të saj. (Evidencë 31. Rregullore GJ-LA; Vizita në institucion: takim me studentët, takim me drejtueset e departamenteve, takim me stafin akademik).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Mbështetur në informacionin në RVB, evidentohet se burimi i informacionit për publikimin e udhëzuesve të posaçëm, të materialeve promovuese si broshura, guida lidhet ngushtësisht me faqen zyrtare të UAMD. GVJ nuk konstaton referenca për fushatat e promovimit ose takime të hapura për studentët e interesuar në këtë program studimi, përveç atyre në faqen zyrtare.			
Konkluzione	<i>UAMD ka parashikuar në rregulloret e zyrave të posaçme si ajo e sekretarisë mësimore dhe njërive bazë, departamentit të gjuhës shqipe dhe letërsisë, që kanë përgjegjësi në shpërndarjen e informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program. GVJ konstaton se personeli akademik kryen prezantimin e kushteve dhe kriterëve të vlerësimit që në javën e parë të zhvillimit të lëndës. GVJ nuk eidenton dokumentacion të mjaftueshëm në dosje për promovimin dhe informimin e të interesuarve mbi programin e studimit, si të dhënat për javën e orientimit, guida e studentit, broshura para promovimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Organizimi i studimeve është i pasqyruar me detaje në rregulloren e UAMD, të FE, të DGJH dhe të programit të studimit. (Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD,kreu III; Evidenca nr.7 – Rregullore FE, kreu V). GVJ evidenton pasaktësi në rregulloren e programit të studimit GJLA, në nenin 14, pika 1 e saj, ku kohëzgjatja (2 vite , 4 semestra) dhe numri krediteve për PS (120 ECTS) nuk korespondojnë me rregulloret qendrore dhe përshkruajnë një program të ndryshëm studimi nga ai i Bachelor Gjuhë Letërsi - Anglisht. Studentët konfirmuan se janë të njohur me strukturën e programit të studimit (Ref 31. Rregullore GJ-LA; Vizita në institucion-takim me studentët; Evidence 25, Rregullore Departamenti, BA, MP, MSH).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton se studentëve u është vënë në dispozicion i gjithë informacioni mbi lëndët që zhvillohen gjatë programit të studimit, si edhe mbi përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese nga departamenti dhe sekretaria mësimore. (Ref.Vizita në institucion, takimi me studentët).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në takimin e zhvilluar me përfaqësues të Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, GVJ mësoi se kjo strukturë organizon takime me studentët, i trajnon ata, i udhëzon dhe i informon drejtpërdrejtë ose përmes faqes së saj online mbi mundësi të ndryshme punësimi në institucionet bashkëpunuese, me të cilat kjo zyrë mban kontakte të vazhdueshme. (Ref Vizita në institucion; ëëë.uamd.edu.al). GVJ konstaton se UAMD ka hartuar strategjinë për këtë sektor (Evidencë 53 Evidence Strategjia e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit 2020-2025). Gjithashtu, është përpiluar udhëzuesi edhe kalendari i aktiviteteve nga Sektori i komunikimit, Alumnit dhe Karrierës për orientimin drejt dhe në tregun e punës. (Evidencë 70 Udhëzues - Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidencë 33. Kalendari i aktiviteteve - Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës).
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për	Takimi informues me stafin akademik, faqja zyrtare ëeb e UAMD, sekretaria mësimore dhe këndet e informacionit vendosin në dispozicion të studentëve informacion të përditësuar mbi procesin mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të

zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	tj. Këto fakte u pohuan gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët aktualë të programit të studimit. (Vizita në institucion).			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Një formë tjetër me të cilën GVJ u njoh sa i takon informimit të studentëve është sistemi i menaxhimit të informacionit, nëpërmjet të cilit, ata informohen mbi organizimin e procesit mësimor dhe shërbime të tjera. (Takimi me studentët e programit të studimit). GVJ nuk konstaton në dosje programin e transparencës për informimin e studentëve.			
Konkluzione	GVJ konstaton lidhur me këtë standard se UAMD ka ngritur strukturat e duhura dhe ka hartuar rregullore për t'i vënë në dispozicion studentëve informacion të hollësishëm mbi veprimtarinë mësimore dhe programin e studimit. GVJ evidenton pasaktësi në rregulloren e programit të studimit GJLA, në nenin 14, pika 1 e saj, ku kohëzgjatja (2 vite , 4 semestra) dhe numri krediteve për PS (120 ECTS) nuk korespondojnë me rregulloret qendrore dhe përshkruajnë një program të ndryshëm studimi nga ai i Bachelor Gjuhë Letërsi - Anglisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Mbështetur në rregulloren e Fakultetit të Edukimit, të sekretarisë mësimore dhe vizitën në insituicon, GVJ evidenton se Zyra e Sekretarisë mësimore dhe njësia bazë disponojnë dhe mbajnë statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi – Anglisht". Konkretisht në analizën e departamentit të letërsisë rezulton se ka patur 9 studentë të diplomuar në programin "Bachelor", Gjuhë Letërsi-Anglisht për vitin akademik 2020 – 2021. (Evidencë 19. Rregullore e Fakultetit të Edukimit; Evidencë 57 Rregullore e sekretarisë; Evidencë 5. Departamenti i Letersise, analize

	vjetore 2020-2021)
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion shoqërues të RVB, konkretisht informacionit të paraqitur në tabelat përmbledhëse, GVJ konstaton se në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi – Anglisht” që ofrohet nga Fakulteti i Edukimit, janë regjistruar në tre vite akademike 73 studentë gjithsej, respektivisht:</p> <p>2022-2023/29 studentë 2021-2022 / 17 studentë 2020-2021/ 27 studentë</p> <p>Nuk rezulton asnjë student i transferuar sipas viteve, por ka patur një (1) transferim sipas brezave (Referencë nr. 108)</p> <p><i>Lidhur me këtë kriter, GVB citon evidencën me numër 36, planin mësimor të Bsc GJLA, por GVJ nuk e gjen këtë referencë në dosje (Evidencë 36 PROCEDURA E FILLIMIT TE AKREDITIMIT).</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Përgjatë vizitës në sekretarinë mësimore dhe në shqyrtimin që i bëri dosjes së vetëvlerësimit, GVJ verifikoi se Fakulteti i Edukimit në përputhje me Ligjin nr.9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, menaxhon përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe ruan në databazën e sekretarisë dhe regjistrat përkatës zyrtarë të dhënat statistikore të studentëve. Gjithashtu, u konstatua se këto të dhëna janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p>(Evidencë 19. Rregullore e Fakultetit të Edukimit; _Evidencë 57 Rregullore e sekretarise; vizita në institucion).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Nga vizita e realizuar në institucion, referuar informacionit në RVB, si edhe dokumentacionit shoqërues të tij, GVJ nuk konstaton akte që lidhen me kontrollin periodik të përvitshëm pranë sekretarisë mësimore për sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në</p>	<p>GVJ konstaton se departamenti i gjuhës shqipe dhe ai i letërsisë hartojnë raporte vjetore periodike, ku pasqyrojnë dhe analizojnë cilësinë e studentëve të regjistruar në programin e studimit “Bsc GJLA”. Përsa i përket treguesve të punësimit të studentëve dhe</p>




hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	drejtimin e duhur të tyre, njësia bazë bashkëpunon me Zyrën e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës. (Evidencë Udhëzues - Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidence 25, Rregullore Departamenti, BA, MP, MSH). GVJ konstaton se është Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës i cili kryen gjurmimin e të punësuarve pas diplomimit në programin e studimit. (Evidencë 30. Të dhëna ALUMNI për punësimin e studentëve të UAMD).			
Konkluzione	<i>GVJ evidentoi nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues në DVV dhe nga vizita në institucion se UAMD ka hartuar rregullore dhe udhëzues për sektorët përkatës, të cilët sigurojnë ruajtjen dhe administriminin e të dhënave nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të të dhënave. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës kryen gjurmimin e studentëve të punësuar pas diplomimit në programin e studimit dhe ruan statistikat respektive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti dhe Rregullorja e UAMD-së ka parashikuar që studentët të përfshihen dhe angazhohen përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, të tilla si: këshilli studentor, senati akademik, bordi i administrimit, komisionet e përhershme të UAMD-së. (Evidencë 3 Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës; Evidenca nr.5 – Rregullore UAMD, nenet 121,122). GVJ sugjeron që studentët të përfshihen edhe në komisione të ndryshme në nivel fakulteti ose departamenti, si për shembull në strukturën “NJSBC” (Evidencë 14. Urdher per ngritjen e NJSBC).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të	Statuti UAMD, (Kreu VII), Rregullorja UAMD, (neni 20) dhe Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurisë së cilësisë, garantojnë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje. Konkretisht, në Senatin akademik, në Komisionin e Përhershëm të garantimit të standarteve të cilësisë dhe në komisione ad hoc si Grupi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë.


jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.				
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	FE dhe departamentet e gjuhës shqipe dhe letërsisë garantojnë përfshirjen e studentëve në procesin e përmirësimit të programit të studimit, e cila reflektohet me angazhimin e tyre në dhënien e mendimit dhe opinionëve në pyetësorët për vlerësimin e programit të studimit si edhe për vlerësimin e personelit akademik. GVJ rekomandon që raportet e dala nga këto pyetësorë të trajtohen duke kryer analizën e përparësive dhe mangësive të programit të studimit, ku të jepen rekomandime dhe sugjerime duke marë në konsideratë opinionet dhe shqetësimet e studentëve. <i>GVJ nuk mbështet arsyetimin e GVB për këtë kriter që lidhet me mendimin e studentëve për ngarkesën mësimore, pasi kjo është çështje e vendim marrjes së njësive kryesore dhe njësive bazë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet përkatëse.</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësive/pedagogut përgjegjës.	GVJ evidenton se studentëve u jepet e drejta për të shprehur mendimin e tyre rreth ankimimit të rezultatit, paraqitjes së kërkesë për rishikim të notës së provimit ose reflektim nga ana pedagogu përgjegjës. Parimet e ndershmërisë së kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve dhe e drejta e ankimimit, janë e përcaktuar në rregulloren e UAMD-së dhe në rregulloren e njësive bazë. Studenët konfirmuan këtë të drejtë pavarësisht se nuk e kishin ushtruar atë, në kushte të mungesës së domosdoshmërisë. (Evidenca nr.5 – Rregullore UAMD, neni 71 49 Evidencë 49. Kodi i Etikës UAMD).			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se studentët e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Lterësi – Anglisht" përfshihen dhe angazhohen përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, si edhe në vlerësimin e procesit akademik në zbatim të ligjit nr 80/2015 dhe sipas Rregullores së UAMD-së.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë

veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ evidenton se në UAMD funksionojnë strukturat e mëposhtme me qëllim shërbimin dhe informimin e studentëve: sekretaria mësimore; departamenti i gjuhës dhe letërsisë; Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; sistemi i menaxhimit të informacionit; faqja zyrtare ëeb e universitetit.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ nuk gjen të dhëna koherente për këtë kriter dhe e vlerëson jo të arsyeshëm argumentimin nga GVB, për sa shprehet në RVB duke iu referuar bashkëpunëtorëve të huaj dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucion e partnere. GVJ gjykon se ky kriter lidhet ngushtësisht me politika të brendshme të institucionit.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Sërish, edhe për këtë kriter GVJ nuk gjen koherencë të përgjigjes nga GVB, e cila lidhet me kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare Erasmus. GVJ gjykon se ky kriter i referohet ngushtësisht veprimtarisë së Sektorit për këshillimin e karrierës në UAMD, për të cilat GVB duhet të ishte shprehur lidhur me programin e studimit.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe	GVJ konstaton se GVB, përsa i përket këtij kriteri në RVB, bën referencë me kërkimin shkencor. GVJ nuk e gjen koherent këtë informacion dhe jo në përputhje më treguesit e këtij kriteri të tilla si: Zyra/njësia e karrierës, Mbledhja dhe përpunimi të dhënave, shkalla dhe cilësia e punësimit)



cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.									
Konkluzione	<i>GVJ, pavarësisht konstatimit se UAMD ka ngritur strukturra të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, vëren se GVB nuk ka pasqyruar informacion koherent që reflekton veprimtarinë e tyre.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në dokumentin nr 55 (evidencë 46) "Raport vjetor për monitorimin e cilësisë" UAMD, 2021-2022 në pikën 4 mësimdhënia, mësimnxënia dhe kërkimi shkencor, jepen të dhëna dhe analizohet ky i fundit, por nuk ka asnjë të dhënë për përmirësimin e metodave të mësimin.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit	Në dokumentin nr.13 Dosje vetëvlerësimi , vërehet puna shkencore e stafit akademik dhe ecuria në të. Në dokumentin nr.54 Udhëzues për mësimdhënien, i cili është një document i hartuar nga UAMD jepen udhëzime për metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Kjo organizohet nga përgjegjësi I departamentit për të parë në mënyrë periodike ecurinë dhe funksionimin e mekanizmave të cilësisë së mësimdhënies dhe të formimit shkencor të stafit akademik.

akademik dhe ndihmësakademik.									
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies si dhe vlerësimin e stafit akademik nëpërmjet pyetsorëve për studentët. (Dokument nr.60). Nuk kemi në dispozicion një pyetsor të plotësuar as çfarë rezultati është vjelë prej tyre. Në Dokumentin 49 është paraqitur edhe një pyetsor për vlerësimin e programit të studimit.								
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nuk ka të dhëna për publikime për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.								
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra duhet të nxiste shembujt pozitive dhe praktikat më të mira, çka nuk e vërejtëm.								
Konkluzione	<i>GVJ vërejt se ka kërkesë për punën shkencore të pedagogëve e cila monitorohet periodikisht, por jo për mësimdhënien. Studentët përfshihen në vlerësimin e cilësisë nëpërmjet pyetësorëve, por këta të fundit duhet të ishin të plotë. Nuk ka të dhëna për publikime për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i	Sigurimi i cilësisë është dhe mbetet një nga kërkesat themelore të

<p>arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>universitetit “Aleksandër Moisiu” për t’iu përgjigjur kërkesave të kohës. Politika e sigurimit të cilësisë në UAMD, është bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Statutin e UAMD-së dhe rregulloret përkatëse. Për të arritur sigurimin e cilësisë UAMD ka zhvilluar një politikë të sigurimit të cilësisë dhe ka ngritur një sistem të menaxhimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka aprovuar me vendim nr 387/ 8 një rregullore “Për funksionimin dhe organizimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” në të cilën ka përcaktuar anëtarët e NjSBC, qëllimin e sigurimit të cilësisë si dhe të gjithë hapat që duhen ndërmarrë që ky process të jetë i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës. (Shih dok.16. Evidencë 11) Evidenca nr 17 që i referohet RVB i përket tjetër çështjeje.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e mësipërme janë përcaktuar të gjitha instrumentet e matjes së cilësisë; si pyetorët për të gjithë aktorët; analizat e përfundimve; njoftimet për përfundimet e nxjerra. Institucioni ka ngritur dhe grupin e personave nga stafi akademik që shqyrton mbarëvajtjen e programit. Akreditimi i jashtëm është kryer vetëm në nivel institucional.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë,</p>	<p>Në rregullore janë përcaktuar qartë treguesit e matshëm të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, por nuk pamë një analizë konkrete të tyre. Për stafin akademik të Departamentit të gjuhës, nga vlerësimi i studentëve përbri emrit është dhënë një përqindje e caktuar, por nuk evidentohet si doli ky rezultat dhe çfarë vlere pati.</p>




institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.				
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se është hartuar një Rregullore e funksionimit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, është ngritur NjSBC por nuk ka analiza të mirëfillta të cilësisë dhe masa të marra në dobi të rritjes së saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga bisedat me përgjegjësat e departamenteve dhe stafin akademik na u bë me dije se Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit bachelor në “Gjuhë – Letërsi- Anglisht” kryhet në mënyrë periodike nga njësitë bazë të Gjuhës shqipe, të Letërsisë dhe të gjuhëve të huaja. Rezultatet dhe mangësitë e evidentuara gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë pasqyrohen në raportin vjetor të analizës mësimore në nivel njësie bazë. Ky informacion i përcillet Njësisë kryesore e cila nga ana e tij harton raportin në nivel Njësie kryesore për ecurinë e procesit mësimor dhe sigurimin e cilësisë.</p> <p>Gjithashtu, njësitë bazë realizojnë në mënyrë periodike analizë të punës mësimore, ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të personelit akademik dhe personelit ndihmës në njësinë bazë, por edhe në nivele të tjera më të larta në qoftë se është e nevojshme. Të gjitha këto shërbejnë për vetëvlerësim të brendshëm dhe vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më</p>	<p>Universitetit “Aleksandër Moisiu” nëpërmjet strukturave të ngritura pranë Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, Zyrës së Mësimit dhe Kurrikulave dhe Zyrës së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional dhe strukturave të tjera në Njësitë kryesore e njësitë bazë të ngritura për këtë qëllim, organizojnë punën,</p>

<p>të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>ndjekin dhe kontrollojnë procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore e programet në zbatimin e tyre, duke përdorur metoda të drejtpërdrejta monitorimi për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së praktikave, seminareve, testeve dhe ushtrimeve, leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta si asistime në auditor, vëzhgohen me kujdes rezultatet e provimeve, shihet ecuria e studentëve në testimin kombëtar. Në evidencën 6/3 jepet një vlerësim nga shefi i departamentit për performancën e një pedagogu. Nuk ka vlerësime paralele të provimeve, po kështu as vlerësime nga Alumni.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin</p>	<p>Njësia kryesore dhe njësitë bazë për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta, si: sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; intervista dhe të drejtpërdrejta si teste të standardizuara; dëgjime në auditor; testime paraprake dhe përfundimtare; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës</p>

e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.									
Konkluzione	<i>GVJ verejti se mungojnë analizat e përhershme dhe marrja e mendimit të të gjithë aktorëve për nivelin e cilësisë. Do të ishte mirë thithja e mendimit të tregut të punës për sudentët e këtij program studimi. Në DVV është paraqitur studimi i tregut të punës për programin Master.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka aprovuar me vendim nr 387/ 8 një rregullore “Për funksionimin dhe organizimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” në të cilën përfshihen gjithë aktorët, staf akademik, student e staf administrativ.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në rregulloren e mësipërme Universitetit “Aleksandër Moisiu” përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së institucioni garanton përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore, si	

<p>programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>përgjegjëse për programin e studimit, si dhe anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ apo dhe studentët e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Integriteti dhe shmangia e diskriminimit janë të saksonuara edhe në Kodin e Etikës të UAMD.(Evidenca 49).</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nuk pamë dokumente që pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vërejtë se aktorët duhet të ishin më të përfshirë qoftë ata të brendshëm , ashtu dhe ata të jashtëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Në mbledhjet dhe raportet vjetore publikohen dhe bëhen të njohura për stafin, por nuk pamë me studentët rezultatet e vlerësimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Universitetit “Aleksandër Moisiu” përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga analizat e kryera institucioni ka marrë shpesh masa për rritjen e cilësisë duke e monitoruar atë. Nxiten pedagogët për punë shkencore, përmirësohet lietratura u qëndrohet afër studentëve për problemet që kanë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të</p>	<p>Nuk ka në mënyrë periodike organizime që ndiqet dhe informohen aktorët për mbarëvajtjen e cilësisë.</p>

studimit.				
Konkluzione	<i>GVJ vëren se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, nuk janë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Gjuhë Letërsi-Anglisht" të ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i Studimit Bachelor në "Gjuhë -Letërsi - Anglisht" është i mbuluar 100% nga personeli akademik efektiv, tregues i cili tejkalon plotësisht kufirin minimal për angazhimin e PAE, sipas kuadrit ligjor në fuqi, **Standardi II.2, Kriteri 1; Standardi III.1, Kriteri 4; Standardi IV.1, Kriteri 1.**
2. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është në rritje të vazhdueshme akademike dhe është i pajisur me grada shkencore dhe tituj shkencorë **Standardi III.1, Kriteri 4.**
3. Institucioni mbështet nga pikëpamja financiare personelin akademik për të zhvilluar projekte individuale kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkim-zhvillimit **Standardi III.1, Kriteri 3.**

Pika të dobëta:

1. Programi i Studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi - Anglisht" ka mungesë të theksuar në kuadrin e përgjithshëm të veprimtarive formuese në kategorinë (B) të lëndëve karakterizuese përse i përket drejtimit "Anglisht", ku evidentohet vetëm një lëndë e përbërë nga dy module, e vlerësuar me 6 ECTS nga 95 kredite që ka në total kjo kategori, **Standardi III.4, Kriteri 1; Standart II.1.**
2. Lëndët e gjuhës angleze janë përqëndruar kryesisht tek lëndët plotësuese, kategoria (D) nën etiketimin sipas kategorie "Gjuhë e Huaj", referuar VKM 41/2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL-të". GVJ gjykon se kjo gjetje nuk përkon me emërtimin e programit të studimit, **Standardi III.4, Kriteri 2.**
3. Ky program është i orientuar përgjithësisht në gjuhë dhe letërsi, por pa e garantuar plotësinë e ofrimit të veprimtarive formuese për secilin drejtim sipas emërtimit të tij, **Standardi III.4, Kriteri 2.**
4. Programi i studimit nuk është shoqëruar me Studimin e Tregut të Punës, që sjell pasoja në evidentimin e dobisë së tij në ofertë, **Standardi II.5 kriteri 1/2/3; Standarti III.2 Kriteri 5.**
5. Evidencat mbi monitorimin e cilësisë dhe ngritjen e instrumentave matës për garantimin e saj nuk janë hartuar në mënyrë periodike, **Standardi VI.1.**

Rekomandime:

1. Të ndryshojë kuadri i përgjithshëm i veprimtarive formuese sipas emërtimit të programit të studimit duke realizuar riorganizimin tërësor të tij.
2. GVJ rekomandon kalimin e lëndëve të gjuhës angleze nga kategoria (D) si lëndë plotësuese në kategorinë B, si lëndë karakterizuese.



3. GVJ rekomandon që disa lëndë me zgjedhje të kategorisë (C) të veprimtarive formuese të programit të studimit, të tilla si: "aplikim kompjuteri në gjuhësi", "analizë diskursi", "shkrim krijues" të cilat aftësojnë studentët në fushën e teknologjisë së informacionit dhe shkencave humane të përfshihen në kategorinë (D) të lëndëve plotësuese në përputhje me VKM 41/2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL-të".
4. Të hartohet Studimi i Tregut të Punës për programin e studimit.
5. Të raportohet periodikisht mbi monitorimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, të dedikuar për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi - Anglisht", duke formalizuar instrumentat matës për kryerjen e këtij procesi në nivel institucional dhe në nivel të njësisë kryesore, me drejtim nga NJSBC.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Language Literature-English" provided by the "Aleksandër Moisiu" University" Durrës

Strengths and affirmations

4. The Study Program Bachelor in "Language - Literature - English" is covered 100% by effective academic staff (PAE), an indicator that completely exceeds the minimum limit for PAE engagement, according to the legal framework in force. **Standard II.2, Kriteria 1; Standard III.1, Kriteria 4; Standard IV.1, Kriteria 1.**
1. The academic staff engaged in the study program is engaged in continuous academic growth and is equipped with scientific degrees and scientific titles **Standardi III.1, Kriteri 4.**
2. The institution financially supports the academic staff to develop individual national and international projects in the field of research and development **Standardi III.1, Kriteri 3.**

Weaknesses

1. The Bachelor Study Program in "Language, Literature - English" has a substantial lack in the general framework of formative activities in category (B) of characteristic subjects in terms of "English" subject orientation, where it is included only one subject consisting of two modules, evaluated with 6 ECTS out of 95 credits that this category (B) has in total. **Standard III.4, Kriteria 1; Standart II.1.**
2. English language subjects are mainly focused on complementary subjects, category (D) under the labeling according to the "foreign language" category referred to Decision of Council of Ministers, VKM 41/2018 "On the elements of study programs offered by HEIs". However, this finding does not go in line with the title of the study program. **Standard III.4, Kriteria 2.**




3. This program is generally oriented towards language and literature, but without guaranteeing the completeness of the provision of formative activities for each direction according to its title. **Standard III.4, Kriteria 2..**
6. This study program was offered to students without the Labor Market Study, which has consequences in the evidence of its usefulness in the offer, **Standard II.5 Kriteria 1/2/3; Standart III.2 Kriteria 5.**
4. To report periodically on the monitoring of internal quality assurance, dedicated to the Bachelor study program in "Language Literature - English", formalizing the measuring instruments for carrying out this process at the institutional level and at the level of the main unit, with direction from NJSBC, **Standard VI.1.**

Recommendations

1. External Evaluation Group (EEG) recommends that the general framework of formative activities change accordingly to the title of the study program by carrying out its complete reorganization.
2. External Evaluation Group (EEG) recommends the transfer of English language subjects from category (D) as complementary subjects to category B, as characterizing subjects.
3. EEG recommends that some optional subjects of category (C) in the formative activities of the study program, such as: "computer application in linguistics", "discourse analysis", "creative writing" integrate into category (D) of supplementary subjects, in accordance with VKM 41/2018 "On the elements of study programs offered by HEIs". This will enable students in the field of information technology, humanities, and social sciences.
4. EEG recommends the designation of the Labor Market Study for the Bachelor study program in "Language Literature - English".
5. EEG recommends periodical reports on the monitoring process by internal quality assurance, dedicated to the Bachelor study program in "Language Literature - English", formalizing the measuring instruments for carrying out this process at the institutional level and at the level of the main unit, with direction from NJSBC.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	